

Udhëzim për prindërit dhe kujdestarët për Mbrojtjen e Fëmijëve Online

2020



AUTORITETI KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK
DHE SIGURINË KIBERNETIKE

Mirënjohje

Ky udhëzim është hartuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunicacionit (ITU) dhe një grup pune me pjesëmarrës nga institucionet kryesore aktive në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) si dhe në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në internet dhe përfshijnë organizatat e mëposhtme:

ECPAT International, Global Kids Online network, International Disability Alliance, International Telecommunications Union (ITU), London School of Economics and Political Science, Internet matters, Parent Zone International dhe UK Safer Internet Centres/SWGfL.

Grupi i punës është drejtuar nga Karl Hopwood (Insafe network of Safer Internet Centres (Insafe))¹ dhe koordinuar nga Fanny Rotino (ITU).

Kontribut i paçmueshëm është dhënë nga COFACE-Families Europe (Australian eSafety Commissioner), European Commission, European Council, e-Worldwide Group (e-WWG), ICMEC, Youth and Media/Berkman Klein Center for Internet and Society në Harvard University si dhe nga përfaqësues të sektorit qeveritar dhe sektorit privat që i bashkon objektivi i përbashkët për të bërë Internetin më të mirë e më të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë.

Ky udhëzim nuk do ishte i mundur pa kohën, entuziazmin dhe dedikimin e autorëve kontribues.

ITU është mirënjohëse ndaj partnerëve, të listuar më poshtë alfabetikisht sipas emrit të organizatës që përfaqësojnë, të cilët kanë kontribuar me kohën dhe njohuritë e tyre:

- Julia Fossi and Ella Serry (Australian eSafety Commissioner)
- Martin Schmalzried (COFACE-Families Europe)
- Livia Stoica (Council of Europe)
- John Carr (ECPAT International)
- Manuela Marta (European Commission)
- Salma Abbasi (e-WWG)
- Laurie Tasharski (ICMEC)
- Lucy Richardson (International Disability Alliance)
- Carolyn Bunting (Internet matters)
- Fanny Rotino (ITU)
- Sonia Livingstone (London School of Economics & Global Kids Online)
- Cliff Manning and Vicki Shotbolt (Parent Zone International)
- David Wright (UK Safer Internet Centres/SWGfL)
- Sandra Cortesi (Youth and Media)

¹ Në kuadër të *Connecting Europe Facility (CEF)*, *European Schoolnet* menaxhon, në emër të Komisionit Europian, platformën *Better Internet for Kids* e cila përfshin koordinimin e rrjetit *Insafe* të *European Safer Internet Centres*. Për më shumë informacion vizitoni www.betterinternetforkids.eu

Disa të drejta të rezervuara. Kjo vepër është licencuar për publikun përmes një licence Creative Commons Attribution-NonCommercial-Share Alike 3.0 IGO (CC BY-NC-SA 3.0 IGO). Sipas kushteve të kësaj licence, ju mund të kopjoni, rishpërndani dhe përshtatni veprën për qëllime jokomerciale, me kusht që vepra të citohet në mënyrë të përshtatshme. Në çdo përdorim të kësaj pune, nuk duhet të ketë sugjerime që ITU të miratojë ndonjë organizatë, produkt ose shërbim specifik. Përdorimi i paautorizuar i emrave ose logove të ITU nuk lejohet. Nëse e përshtatni punën, atëherë duhet të licenconi punën tuaj nën të njëjtën licencë ose ekuivalente të Creative Commons. Nëse krijoni një përkthim të kësaj vepre, duhet të shtoni mohimin e mëposhtëm së bashku me citimin e sugjeruar: "Ky përkthim nuk është krijuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU). ITU nuk është përgjegjës për përmbajtjen ose saktësinë e këtij përkthimi. Botimi origjinal në anglisht do të jetë botimi detyrues dhe autentik ”.

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni: <https://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/3.0/igo/>

Fjalë përshëndetëse

ITU ka hartuar setin e pare të udhëzimeve mbi Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet (COP) në 2009. Qëllimi ynë, në atë kohë, ka konsistuar në krijimin e një kornize të pranuar ndërkombëtarisht nga aktorë të ndryshëm – prindër dhe kujdestarë, industria, politikëbërësit dhe fëmijët – për të siguruar përdorimin e sigurtë të Internetit nga fëmijët e të rinjtë.

Që atëherë, Interneti ka evoluar përtej çdo parashikimi. Ai është një burim më i pasur për fëmijët, i cili ofron lojra educative, aktivitete zbavitëse dhe mënyra të ndryshme për të shpërndarë, për të mësuar dhe për të komunikuar me miqtë, familjarët e të tjerët. Por në të njëjtën kohë, është kthyer në një hapësirë të rrezikshme për fëmijët e pambikëqyrur.

Nga çështje si privatësia, lajmet e rreme, në promovimin e përmbajtjes së dhunshme dhe të papërshtatshme, mashtrimet në Internet dhe fenomenet e online grooming dhe abuzimi e shfrytëzimi seksual, fëmijët dhe kujdestarët e tyre përballen me rreziqe dhe sfida të shumta.

Gjithashtu, gjatë pandemisë globale COVID-19 u vu re një rritje e numrit të fëmijëve që aksesonin internetin për herë të parë, për të studiuar dhe për të ruajtur ndërveprimin social. Për shkak të kufizimeve të vendosura, fëmijët e të rinjtë filluan të ndërvepronin me Internetin më shpejt sesa ishte parashikuar nga prindërit e tyre dhe si rezultat i angazhimeve të punës prindërit nuk arritën t'i mbikëqyrin fëmijët e tyre, duke i ekspozuar ndaj aksesimit të përmbajtjeve të papërshtatshme ose duke i bërë target të kriminelëve në prodhimin e materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve.

Në këtë kuadër, vendet anëtare të ITU Member States kanë kërkuar rishikim të udhëzimeve ekzistuese për Mbrojtjen e Fëmijëve Online (COP). Në vend të rishikimit, udhëzimet e reja janë ri-shkruar dhe ri-dizenjuar nga fillimi, për të reflektuar ndryshimet thelbësore të mjedisit digjital në të cilin e gjejnë veten fëmijët e të rinjtë sot.

Për ju, përdoruesit e këtij udhëzimi, qëllimi i këtij dokumenti është të rritë ndërgjegjësimin mbi sfidat e përdorimit të internetit dhe tu ofrojë një burim, i cili do tju ndihmojë të mbështesni në mënyrë efektive të rinjtë gjatë përdorimit të internetit. Ky udhëzim do tju sensibilizojnë ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të internetit, si dhe do tju ndihmojë të kultivoni një mjedis digjital të shëndetshëm dhe fuqizues në shtëpi e në shkollë. Udhëzimi thekson rëndësinë e komunikimit të hapur dhe dialogut të vazhdueshëm me fëmijët e të rinjtë, për të krijuar një hapësirë të sigurtë ku ata të ndihen të sigurtë për të shprehur shqetësimet.

Përveç pasqyrimin të zhvillimeve të reja në teknologji dhe platformat digjitale, ky udhëzim adreson një boshllëk të rëndësishëm: situatën me të cilën përballen fëmijët me aftësi të kufizuara, për të cilët Interneti ofron një kufij të rëndësishëm për të mbushur dhe përmbushur pjesëmarrjen sociale. Gjithashtu janë parashikuar nevojat special të grupeve vulnerabël dhe fëmijëve që emigrojnë.

Në emër të rolit të ITU si coordinator global, jam krenar për faktin se ky udhëzim i rishikuar është produkt i një përpjekjeje bashkëpunuese globale, pasi bashkëautorë janë ekspertë nga një komunitet i madh me aktorë të shumtë.

Kam kënaqësinë të prezantoj personazhin e ri të COP, Sango, një karakter miqësor, i pandrojtur dhe i patrembur i projektuar tërësisht nga një grup fëmijësh, si pjesë e një programi ndërkombëtar i ITU për të rinjtë.

Në një epokë ku gjithnjë e më shumë të rinj kanë akses në internet, udhëzimet COP janë më jetike se kurrë. Prindërit dhe kujdestarët, industria, politikëbërësit - dhe vetë fëmijët - të gjithë së bashku luajnë një rol jetik në sigurinë e fëmijëve në internet. Shpresoj që këto udhëzime do të jenë të dobishme ndërsa shoqëroni fëmijët në kujdesin tuaj në udhëtimin e jashtëzakonshëm për të zbuluar mundësitë mahnitëse që ofron interneti.



Doreen Bogdan-Martin
Drejtor, Telecommunication Development Bureau

Tabela e përmbajtjes

Mirënjohje	2
Fjalë përshëndetëse.....	4
Përmbledhje ekzekutive	7
1. Hyrje	9
2. Çfarë është mbrojtja e fëmijëve në Internet?	11
3. Fëmijët dhe të rinjtë në një botë të lidhur	12
4. Fëmijët vulnerabël	24
5. Rreziqe dhe sfida të reja	27
6. Kuptimi i rreziqeve dhe dëmeve	33
7. Roli që luajnë prindërit dhe kujdestarët	40
8. Udhëzues për prindërit, kujdestarët dhe rojet	44
9. Roli i kujdestarëve.....	51
10. Udhëzime për kujdestarët	57
11. Përfundim	60
Terminologjia.....	61

Përmbledhje ekzekutive

Sipas të dhënave të ITU, në 2019 rreth 4.1 miliardë njerëz e përdornin internetin, duke reflektuar një rritje prej 5.3% krahasuar me vitin 2018.

Fëmijët dhe të rinjtë e përdorin internetin për qëllime të ndryshme, nga marrja e informacionit për një projekt shkolle deri te biseda me miqtë. Ata kanë aftësi të shumta teknologjike për përdorimin e programeve dhe aplikacioneve komplekse, si dhe aksesojnë internetin nëpërmjet celularëve, tabletave dhe pajisjeve të tjera si ora, iPod, lexues të librave online dhe lojrat elektronike.²

Interneti ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën e fëmijëve dhe të rinjve të grupmoshave të ndryshme. Për fëmijët emigrantë interneti ruan lidhjet me familjen dhe miqtë dhe ofron një dritare në kulturën e vendbanimit të tyre të ri. Ai mundëson që fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të socializohen dhe të përfshihen në aktivitete që nuk mund të kryhen në botën fizike, dhe ofron mundësi të barabarta për të ecur me bashkëmoshatarët e tjerë online, duke evidentuar aftësitë më tepër sesa kufizimet.

Megjithatë, Interneti përveç ofrimit të aksesit dhe mundësive, paraqet gjithashtu edhe rreziqe. Për shembull, për fëmijët dhe të rinjtë emigrantë, pasojat e thyerjes së konfidencialitetit të informacionit online mund të jenë shumë të rrezikshme – në duart e gabuara, të dhënat mund të përdoren për të identifikuar dhe targetuar njerëzit bazuar në përkatësinë etnike, statusin e imigrimit ose të dhëna të tjera identifikuese³; për fëmijët e të rinjtë me spektër autik (ASD), sfidat sociale si vështirësia e të kuptuarit të qëllimeve të tjerëve, mund ta bëjë këtë grup vulnerabël ndaj “miqve” me qëllime dashakeqe; dhe fëmijët e të rinjtë me aftësi të kufizuara janë më të prirur drejt fenomeneve të përjashtimit, stigmatizimit dhe manipulimit.

Shpesh prindërit dhe kujdestarët mendojnë se fëmija i tyre është më i sigurtë kur e përdor kompjuterin në shtëpi ose në shkollë, krahasuar me vendet e tjera. Ky është një perceptim i rrezikshëm, sepse Interneti mund ti çojë fëmijët e të rinjtë kudo në botë, dhe gjatë kësaj kohe ata mund të ekspozohen ndaj përmbajtjeve të rrezikshme, ashtu siç mund të ndodhë në botën fizike. Megjithatë, fëmijët dhe të rinjtë përjetojnë rrezik më të lartë kur e aksesojnë Internetin në telefona celularë, tabletë ose çdo pajisje tjetër që mund të mbahet në dorë. Kjo ndodh për arsye se pajisjet që mbahen në dorë ofrojnë akses të menjëhershëm në Internet nga kudo dhe janë më pak të monitoruara nga prindërit ose kujdestarët.

Këto udhëzime janë zhvilluar në kuadër të iniciativës për mbrojtjen e fëmijëve në Internet, si pjesë e Agjendës Globale për Sigurinë Kibernetike të ITU⁴, me qëllim krijimin e bazave për të mjedis kibernetik më të sigurtë për të rinjtë e sotëm dhe për brezat e ardhshëm.

Këto udhëzime përqendrohen gjithashtu tek fëmijët vulnerabël, veçanërisht, fëmijët emigrantë, fëmijët me ASD dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

² ITU, (2019), Measuring digital development. Facts and figures 2019, <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/FactsFigures2019.pdf>.

³ UNICEF (2017), *The State of the World's Children 2017: Children in a Digital World*, <https://www.unicef.org/uzbekistan/media/711/file/SOWC:%20Children%20in%20a%20Digital%20World.pdf>.

⁴ ITU (2020), *Global Cybersecurity Agenda (GCA)*, <https://www.itu.int/en/action/cybersecurity/Pages/gca.aspx>.

Udhëzimet hartohen për të vepruar si një plan që mund të përshtatet dhe të përdoret në një mënyrë që është në përputhje me zakonet dhe ligjet kombëtare ose lokale dhe adreson çështje që mund të prekin të gjithë fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 18 vjeç.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve përkufizon një fëmijë si çdo person nën moshën 18 vjeç. Këto udhëzime adresojnë çështje me të cilat përballen të gjithë personat nën moshën 18 vjeç në çdo cep të botës. Sidoqoftë, një përdorues shtatë vjeçar, i cili është në fillimet e përdorimit të internetit, jodomosdoshmërisht mund të ketë të njëjtat nevoja ose interesa si një 12-vjeçar në pritje të Shkollës së Mesme apo një 17-vjeçar në prag të moshës madhore. Këto udhëzime janë përshtatur për të dhënë këshilla ose rekomandime në kontekste të ndryshme sepse nevojat specifike kërkojnë shqyrtim individual dhe se faktorë të ndryshëm lokalë, ligjorë dhe kulturorë kanë një ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si këto udhëzime mund të përdoren ose interpretohen në çdo vend apo rajon të caktuar.

1. Hyrje

Në nivel global, një në tre përdorues të Internetit është nën moshën 18 ⁵, një numër jashtëzakonisht i madh, i cili tregoi se në vitin 2018, më shumë se gjysma e popullsisë së botës përdornin internetin. Ndërkohë në vendet në zhvillim, fëmijët janë në krye të përdorimit të internetit, pasi po rriten në praninë e internetit të lidhur fillimisht me telefonat mobile.⁶

Me një numër gjithnjë e në rritje të fëmijëve që fitojnë akses në internet, përmbushja e të drejtave të tyre do të varet gjithnjë e më shumë nga ajo që ndodh online. Aksesit në internet është thelbësor në realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Pavarësisht raportit që një në tre fëmijë është përdorues i Internetit, ka ende rreth 346 milion fëmijë në të gjithë botën që nuk kanë akses në Internet.⁷ Ata që mund të përfitojnë nga përdorimi i internetit, zakonisht kanë më pak akses në të. Ne shohim që në rajonin e Afrikës rreth 60% e fëmijëve nuk janë të lidhur në internet, krahasuar me 4% në Evropë.⁸

Për sa i përket aksesit në internet, ka dallime të konsiderueshme edhe sipas gjinisë. Hulumtimet⁹ tregojnë se në çdo rajon përveç Amerikës, meshkujt janë më të shumtë në numër se femrat sipas përdorimit të Internetit. Në shumë vende, vajzat nuk kanë të njëjtat mundësi aksesimi si djemtë, madje edhe atje ku kanë, vajzat shpesh monitorohen dhe kufizohen në përdorimin e Internetit.

Ndarjet digjitale tejkalojnë çështjen e aksesit. Fëmijët që mbështeten në përdorimin e celularëve më tepër se kompjuterat marrin një përvojë të dytë më të mirë në internet ndërsa ata që nuk kanë aftësi digjitale ose flasin gjuhë të pakicave shpesh nuk mund të gjejnë përmbajtjet e duhura përkatëse në internet. Fëmijët e zonave rurale kanë më shumë mundësi të bien pre e vjedhjeve të fjalëkalimeve ose parave. Ata gjithashtu kanë tendencë të kenë aftësi më të ulëta digjitale, të kalojnë më shumë kohë në internet (veçanërisht duke luajtur lojëra) dhe të marrin më pak përkushtim dhe monitorim nga prindërit.¹⁰

Si fëmijët ashtu edhe të rriturit, raportojnë se ndarja digjitale është një shqetësim i vazhdueshëm dhe kërkon investime të dedikuara dhe zgjidhje kreative. Aksesit i fëmijëve në Internet po vjen gjithnjë e në rritje dhe ende shumë prej tyre nuk përfitojnë nga format e

⁵ Livingstone, S., Carr, J., and Byrne, J. (2015) *One in three: The task for global internet governance in addressing children's rights*. Global Commission on Internet Governance: Paper Series. London: CIGI and Chatham House, <https://www.cigionline.org/publications/one-three-internet-governance-and-childrens-rights>

⁶ ITU (2020), *Measuring the Information Society Report*, https://www.itu.int/dms_pub/itu-d/opb/ind/D-IND-ICTOI-2018-SUM-PDF-E.pdf

⁷ UNICEF (2017), *The State of the World's Children 2017: Children in a Digital World*, <https://www.unicef.org/uzbekistan/media/711/file/SOWC:%20Children%20in%20a%20Digital%20World.pdf>.

⁸ UNICEF.

⁹ Araba Sey and Nancy Hafkin (2019), *REPORT OF EQUALS RESEARCH GROUP, LED BY THE UNITED NATIONS UNIVERSITY (United Nations University and EQUALS Global Partnership)*, <https://i.unu.edu/media/cs.unu.edu/attachment/4040/EQUALS-Research-Report-2019.pdf>.

¹⁰ UNICEF (2019). *Growing up in a connected world*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence, <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/GKO%20Summary%20Report.pdf>.

përshtatshme të udhëzimit nga prindërit, mësuesit dhe kujdestarët e tjerë. Kjo i vendos fëmijët në rrezik.

Interneti është kthyer në një teknologji jashtëzakonisht të pasur dhe të fuqishme. Fëmijët dhe të rinjtë janë përfituesit kryesorë të internetit dhe teknologjive digjitale. Këto teknologji po transformojnë mënyrën se si ne komunikojmë me njëri-tjetrin dhe kanë krijuar shumë mënyra të reja për të luajtur lojëra, për të shijuar muzikë dhe për t'u angazhuar në një sërë aktivitete të kulturore, duke hequr shumë barriera. Fëmijët mund të zgjerojnë horizontin e tyre në internet, duke përfituar nga mundësitë për të mbledhur informacion dhe për të krijuar e mbajtur marrëdhëniet. Aksesit në TIK u ofron fëmijëve aftësi për shkrim-lexim, të cilat largojnë forma të tjera të pjesëmarrjes offline. Interneti siguron qasje në shëndetësi, shërbime arsimore dhe informacione mbi tema që janë të rëndësishme për të rinjtë, por që mund të jenë tabu në shoqëritë e tyre. Fëmijët dhe të rinjtë janë qenë shpesh përballë adoptimit dhe përshtatjes së mundësive të ofruara nga interneti..

Sidoqoftë, është e pamohueshme që Interneti ka sjellë në vazhden e tij një sërë sfidash për sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve, të cilat duhet të adresohen, jo vetëm sepse janë të rëndësishme në vetvete, por edhe sepse është i rëndësishëm komunikimi me të gjithë personat e mendimit se interneti është një medium që mund t'i besohet. Po kështu, është thelbësore që shqetësimi për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë në internet të mos lejohet të bëhet një platformë për të justifikuar një sulm ndaj fjalës së lirë, shprehjes së lirë ose lirisë së asociimit.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që brezi i ardhshëm të ndihet i sigurt në përdorimin e internetit në mënyrë që ata, nga ana tjetër, të vazhdojnë të përfitojnë nga zhvillimi i tij. Kështu, kur diskutohet për sigurinë e fëmijëve dhe të rinjve në internet, është thelbësore të vendoset ekuilibri i duhur.

Është thelbësore të diskutohen hapur rreziqet që ekzistojnë për fëmijët dhe të rinjtë në internet, për t'i mësuar ata se si të njohin rrezikun dhe për të parandaluar ose trajtuar dëmet nëse ato materializohen, pa i frikësuar apo ekzagjeruar padrejtësisht rreziqet.

Çdo qasje që merret vetëm ose kryesisht me aspektet negative të teknologjisë jo gjithmonë merret seriozisht nga fëmijët dhe të rinjtë. Prindërit dhe mësuesit shpesh mund ta gjejnë veten në disavantazh sepse të rinjtë do të dinë më shumë mbi teknologjinë dhe mundësitë e saj sesa gjeneratat e vjetra. Hulimtimet kanë treguar se shumica e fëmijëve janë në gjendje të dallojnë ngacmimin në internet nga shakatë ose bullizmin në internet, duke ditur që bullizmi në internet është krijuar për të dëmtuar. Në shumë vende të botës, fëmijët me të vërtetë kanë një botëkuptim të mirë të disa prej rreziqeve me të cilat përballen në internet¹¹.

Sidoqoftë, ndërsa shihet se përpjekjet për t'i aftësuar fëmijët të menaxhojnë rreziqet në internet janë efektive, ka ende hapësirë për të rritur ndërgjegjësimin e fëmijëve në të gjithë botën, veçanërisht në grupe të vulnerabël. Përpjekjet e shumta duhet të përqendrohen tek ky grup, veçanërisht për të përmirësuar ndërgjegjësimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e ngacmimit në internet dhe formave të tjera të rreziqeve në internet.

Na presin shumë sfida përpara. Jo vetëm aksesit në botën digjitale paraqet probleme. Shkalla e ndryshimit teknologjik paraqet sfida për sigurinë e fëmijëve në internet. Shumë fëmijë

¹¹ Since 2016, ITU undertakes consultations within COP with children and adult stakeholders on relevant issues such as cyberbullying, digital literacy and children's activities online.

lundrojnë në një hapësirë komplekse të mediave dixhitale. Zhvillimet në inteligjencën artificiale, realiteti virtual, BigData, njohja e fytyrës, robotika dhe Internet of Things janë vendosur të transformojnë praktikën mediatike të fëmijëve edhe më tej.

Thelbësore është që të gjithë palët e interesuara të planifikojnë dhe të mendojnë për pasojat e këtyre zhvillimeve për fëmijët. Duhet të gjejnë mënyra për t'i mbështetur ata për të zhvilluar njohuritë dixhitale jo vetëm për të mbijetuar, por për të lulëzuar në të ardhmen dixhitale. Kërkohej investim i mëtejshëm në aftësitë dixhitale të prindërve dhe mësuesve për të mbështetur fëmijët për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik dhe vlerësues, për t'i mundësuar atyre të lundrojnë në rrjedha të shpejta informacioni me cilësi të ndryshme, nga prindërit dhe kujdestarët të fëmijët, për t'u bërë qytetarë dixhitalë.¹²

Konsultimet e ITU kanë demonstruar se disa vende kanë vështirësi në alokimin e burimeve të mjaftueshme për të trajtuar njohuritë dhe sigurinë dixhitale të fëmijëve në internet. Sidoqoftë, fëmijët raportojnë se prindërit, mësuesit, kompanitë e teknologjisë dhe qeveritë janë të gjithë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e zgjidhjeve për të mbështetur sigurinë e tyre në internet. Një studim i ITU i Shteteve Anëtare (Member States), tregon se ka mbështetje të konsiderueshme për përfitimin e njohurive dhe përpjekjet e koordinuara për të rritur sigurinë e një numri të madh të fëmijëve në internet.

Balancimi i mundësive dhe rreziqeve të fëmijëve në internet mbetet një sfidë. Shtetet Anëtare të ITU gjithashtu treguan se ndërsa përpjekjet për të promovuar mundësi për fëmijët në internet duhet të vazhdojnë të jenë një përparësi, kjo duhet të balancohet me kujdes me të drejtat për kushte të sigurta në të cilat ata mund të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga bota dixhitale.¹³

2. Çfarë është mbrojtja e fëmijëve në Internet?

Interneti ofron shumë mundësi që fëmijët dhe të rinjtë të komunikojnë, të mësojnë aftësi të reja, të jenë krijues dhe të kontribuojnë në krijimin e një shoqërie më të mirë. Por ato gjithashtu mund të sjellin rreziqe të reja të tilla si ekspozimi i tyre ndaj çështjeve të privatësisë, përmbajtjes së paligjshme, ngacimit, keqpërdorimit të të dhënave personale, pastrimit dhe madje abuzimit seksual të fëmijëve.

Këto udhëzime japin një qasje holistike për t'iu përgjigjur të gjitha kërcënimeve dhe dëmeve të mundshme që fëmijët dhe të rinjtë mund të hasin kur aksesojnë internetin. Ata pranojnë që të gjithë palët e interesuara kanë një rol në qëndrueshmërinë, mirëqenien dhe mbrojtjen e tyre dixhitale ndërsa përfitojnë nga mundësitë që mund të ofrojë Interneti.

Mbrojtja e fëmijëve është një përgjegjësi e përbashkët dhe u takon të gjithë faktorëve përkatës të sigurojnë një të ardhme të qëndrueshme. Që të ndodhë kjo, politikëbërësit, sektori privat, prindërit, kujdestarët, edukatorët dhe palët e tjera të interesit, duhet të sigurojnë që fëmijët mund të përmbushin potencialin e tyre - në internet dhe offline.

Prindërit, kujdestarët dhe arsimtarët gjithashtu kanë përgjegjësi të sigurojnë që fëmijët dhe të rinjtë po përdorin faqet e Internetit në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.

¹² Council of Europe (2016), *Digital Citizenship Education*, <https://www.coe.int/en/web/digital-citizenship-education/home>.

¹³ ITU News (2018), *Celebrating 10 Years of Child Online Protection*, <https://news.itu.int/celebrating-10-years-child-online-protection/>.

Në vitet e fundit, aksesit në Internet është rritur jashtëzakonisht shumë dhe nuk ka asnjë zgjidhje fikse për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë në internet. Kjo është një çështje globale që kërkon një përgjigje nga të gjithë anëtarët e shoqërisë, përfshirë vetë fëmijët dhe të rinjtë.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave në rritje përballë zhvillimit të shpejtë të TIK, Iniciativa për Mbrojtjen Online të Fëmijëve (COP)¹⁴, një iniciativë ndërkombëtare me shumë aktorë e nisur nga ITU në nëntor 2008, vazhdon të sjellë partnerë së bashku nga të gjithë sektorët e komunitetit ndërkombëtar për të krijuar një përvojë të sigurt dhe fuqizuese në internet për fëmijët dhe të rinjtë në të gjithë botën. Ai përcakton udhëzimet për të gjithë aktorët përkatës, përfshirë fëmijët dhe të rinjtë kudo në botë, se si të mbajnë veten dhe të tjerët të sigurt në internet. Këto udhëzime veprojnë si një plan, i cili mund të përshtatet dhe të përdoret në një mënyrë që është në përputhje me zakonet dhe ligjet kombëtare ose lokale.

Ky raport është përgatitur brenda Inicativës COP nga një grup pune ekspertësh dhe synon të ofrojë informacione dhe këshilla të sigurisë për prindërit, kujdestarët dhe edukatorët për mbrojtjen e fëmijëve në internet.

Një grup pune i ekspertëve ITU është bashkëautor i udhëzimeve në këtë raport, duke u bazuar në Udhëzimet e para ITU COP, të botuara në 2009 dhe të azhuruara në 2016. Me kërkesë të Shteteve Anëtare të ITU, kjo e fundit nisi procesin e rishikimit në 2019 dhe synoi të zhvillonte një version të dytë të udhëzimeve.

Këto udhëzime të reja përfshijnë situatën e veçantë të fëmijëve me aftësi të kufizuara kur bëhet fjalë për rreziqet dhe dëmet në internet, si dhe çështje rreth zhvillimeve të teknologjisë së re të tilla si interneti në celular, aplikacionet, Internet of Things, lojrat e lidhura me Internet, robotika, machine learning , dhe inteligjenca artificiale.

3. Fëmijët dhe të rinjtë në një botë të lidhur ¹⁵

Në nivel global, është vlerësuar se një në tre fëmijë është përdorues i Internetit dhe se një në tre përdorues të Internetit është një person nën moshën 18 vjeç.¹⁶ Në vitin 2017, është vlerësuar se gjysma e popullsisë së botës përdor internetin; ndërmjet grupmoshës 15 deri 24 vjeç, përqindja u rrit në rreth dy të tretat.

¹⁴ ITU (2020), *Child Online Protection*, <https://www.itu.int/en/cop/Pages/default.aspx>.

¹⁵ This chapter is mainly drawn from the following source: UNICEF (2019). *Growing up in a connected world*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence, <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/GKO%20Summary%20Report.pdf>. The comprehensive research, as part of the comparable high-quality evidence work of the Global Kids Online, collects voices from children in 11 countries, across 4 regions, from 2016 to 2018 (14,733 children aged 9-17 years). The report focuses at the positive effects of ICTs for children and asks at the same time when the use of ICTs becomes problematic in children's lives. All figures of chapter 4 here below are taken from this report. Qualitative and quantitative methodology on which these findings are based can be found at Livingstone, S., Kardefelt Winther, D., and Saeed, M. (2019). *Global Kids Online Comparative Report, Innocenti Research Report*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence. Online under: <https://www.unicef-irc.org/publications/1059-global-kids-online-comparative-report.html> Further information on the Global Kids Online international research project can be found online under: <http://globalkidsonline.net>.

¹⁶ Livingstone, S., Carr, J., and Byrne, J. (2015) *One in three: The task for global internet governance in addressing children's rights*. Global Commission on Internet Governance: Paper Series. London: CIGI and Chatham House, <https://www.cigionline.org/publications/one-three-internet-governance-andhttps://www.cigionline.org/publications/one-three-internet-governance-and-childrens-rights>

“Ne jemi rritur me internet. Pra interneti ka qenë gjithmonë këtu me ne. Ndërkohë që të rriturit reagojnë: ‘Uau u shfaq interneti’, për ne është krejtësisht normale.” – Shprehet një djale 15-vjeçar nga Serbia.

Midis fëmijëve dhe të rinjve, pajisja më e popullarizuar për të aksesuar internetin është telefoni celular. Kjo përfaqëson një ndryshim të dukshëm gjatë dekadës së kaluar. Në Europë dhe Amerikën e Veriut, gjenerata e parë e përdoruesve të Internetit u regjistrua përmes kompjuterit desktop, por modeli në shumicën e vendeve në zhvillim ishte përdoruesi i internetit 'mobile-first'.

Telefonat celularë preferohen më së shumti pasi mund t’i marrësh me vete kudo; nuk të duhet t’i ndash me pjesëtarë të familjes; mund të kryesh disa veprime në të njëjtën kohë si përshembull të dërgosh mesazhe, të flasësh në telefon, të shpërndash fotografi, të lundrosh në internet dhe më kryesorja është gjithmonë i ndezur.

“Telefoni është disi më i thjeshtë. Ne mund ta marrim kudo, është më i vogël dhe është më i lehtë për të punuar në të. Më pëlqen më shumë në këtë mënyrë (duke e përdorur) me gishta dhe jo me tastierë.” – Shprehet një vajzë 12 vjeçare nga Serbia.

Sondazhet kanë treguar se midis fëmijëve dhe të rinjve që kanë qasje në internet, vajzat dhe djemtë kanë nivele të ngjashme të përdorimit të telefonit celular për të lundruar në internet. Nga ana tjetër kompjuterët desktop zakonisht përdoren më së shumti nga djemtë.

Në praktikë, shumica e fëmijëve dhe të rinjve hyjnë në internet përmes më shumë se një pajisjeje dhe tendenca priret te djemtë që përdorin më shumë pajisje sesa vajzat në çdo vend të anketuar.

Fëmijët dhe të rinjtë kalojnë mesatarisht dy orë në ditë gjatë javës dhe përafërsisht dyfishi i kësaj kohe gjatë fundjavës. Disa janë të lidhur gjatë gjithë kohës. Por shumë të tjerë ende nuk kanë qasje në internet në shtëpi-ose e kanë të kufizuar. Sidoqoftë, statistikat ndryshojnë shumë dhe ekziston një spektër pikëpamjesh mbi kohën që po kalojnë fëmijët në internet. Disa studime të fundit nga Instituti DQ sugjerojnë se në Australi fëmijët dhe të rinjtë mund të kalojnë deri në 38 orë në javë të lidhur në internet.¹⁷

“Unë shkoj në një kafene sepse nuk kemi një kompjuter në shtëpi... Ne nuk kemi akses në internet në shkollë.” – Shprehet një djalë, mosha (15–17) vjeç, në Afrikën e Jugut.

“[Jam në linjë] Gjithë ditën, por nuk e përdor gjatë gjithë kohës.” – Shprehet një djalë, mosha 13–14 vjeç, në Argentinë.

Pavarësisht nga rezultatet e Global Kids Online (GKO) se midis vajzave dhe djemve ka një numër të ngjashëm që aksesojnë internetin, në disa vende, djemtë kanë më shumë liri mbi përdorimin e Internetit sesa vajzat dhe këto të fundit monitorohen dhe kufizohen më shpesh në përdorimin e internetit.

Një botë argëtimi

Fëmijët dhe të rinjtë shpesh aksesojnë internetin për disa arsye argëtimi. Në 11 vendet e anketuara, aktiviteti më i klikuar - për vajzat dhe djemtë - është shikimi i videoklipeve. Më shumë se tre të katërtat e fëmijëve dhe të rinjve që përdorin Internetin, shprehen se ata shohin video në internet vetëm ose me anëtarët e familjes të paktën një herë në javë.

¹⁷ DQ Institute (2020), Child Safety Index, <https://www.dqinstitute.org/child-online-safety-index/>


“Kur nëna ime bleu laptopin, ne filluam të kalonim më shumë kohë së bashku; çdo fundjavë kemi zgjedhur një film dhe e kemi parë me gjyshen time.” –Shprehet një vajzë 15 vjeçare, në Uruguaj.

Fëmijët dhe të rinjtë gjithashtu argëtohen duke luajtur lojëra në internet, duke ushtruar kështu të drejtën e tyre për të luajtur dhe rrjedhimisht të drejtën e tyre për të mësuar. Djemtë priren më shumë të luajnë lojëra online sipas të gjithë vendeve të anketuara. Sidoqoftë, shumë vajza që përdorin internetin rezultojnë të luajnë lojëra online; për shembull, pjesa më e madhe e vajzave luajnë lojëra online në Bullgari (60%) dhe Mal të Zi (80%). Ashtu si në shikimin e videove, fëmijët dhe të rinjtë priren të luajnë lojëra në internet kur kanë akses më të lehtë në internet.

"Unë luaj lojëra online dhe fitoj para prej tyre." – Shprehet një djalë 17 vjeç, në Filipine.

Nga ana tjetër të rriturit janë të shqetësuar mbi kohën e tepërt që fëmijët dhe të rinjtë shpenzojnë para ekranit ose besojnë se ata thjesht po humbasin kohë duke u argëtuar në internet. Sipas Global Kids Online, këto aktivitete kryesore argëtuese mund të ofrojnë mundësi të dobishme për fëmijët dhe të rinjtë, të cilat mund t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë interesin dhe aftësitë për të përparuar më tej drejt përvojave më arsimore, informuese dhe sociale në internet.

Figura 1: Fëmijët (%) që luajnë lojëra në internet të paktën çdo javë sipas gjinisë dhe moshës¹⁸



Question C4z-aa: How often have you played online games alone or with other people in the past month? Base: All children who use the internet.

Question C4z-aa: How often have you played online games alone or with other people in the past month? Base: All children who use the internet.

Figura 1 tregon dy grafikë që ilustrojnë përgjigjet mbi një sondazh të përdorimit të internetit nga fëmijët: Sa shpesh keni luajtur lojëra në internet; vetëm apo me të tjerë muajin e kaluar? Një tabelë ilustron ndarjen e përdorimit midis vajzave dhe djemve, me djemtë që e përdorin atë më shumë në çdo rast. Grafiku tjetër tregon ndarjen sipas grupmoshës. Kjo është një prerje më pak e qartë, me shtatë nga dhjetë vendet e listuara që tregojnë se grupi i 9-11 vjeçarëve luan aq shumë ose më shpesh sesa dy grupet e tjera (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç).

¹⁸ This figure was taken from: UNICEF (2019). *Growing up in a connected world*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence, <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/GKO%20Summary%20Report.pdf>


Krijimi i lidhjeve të reja

Interneti, me ofrimin e komunikimit të menjëhershëm dhe rrjetet sociale, është bërë një pikë e rëndësishme takimi ku fëmijët dhe të rinjtë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes duke u lidhur me miqtë, familjen e tyre dhe me fëmijë e të rinj të tjerë që ndajnë interesa të përbashkëta. Në 11 vendet e anketuara, shumë fëmijë dhe të rinj mund të konsiderohen 'socializues aktivë', pra ata marrin pjesë në një sërë aktiviteteve sociale në internet çdo javë - të tilla si biseda me miqtë dhe familjen. Disa fëmijë gjithashtu raportojnë se e kanë më të lehtë të shprehin vetveten më mirë në internet.

"Në internet, unë mund të tregoj vërtetë mbi veten time, nuk ka rregulla ... Unë kam më shumë se 5 000 miq në internet"- Shprehet një djalë 15 vjeçar që identifikohet si homoseksual, në Filipine.

Ndërveprimet shoqërore në internet gjithashtu rriten me moshën për shkak të arsyeve të ndryshme. Për shembull, disa uebfaqe të mediave sociale kanë një kufi minimal moshe për fëmijët dhe të rinjtë, duke fituar kështu më shumë liri me rritjen në moshë.

Figura 2: Fëmijët (%) që kryejnë tre ose më shumë aktivitete sociale në internet të paktën çdo javë, sipas gjinisë dhe moshës¹⁹



Question C4: How often have you done these social activities online in the past month? Base: All children who use the internet.

Question C4: How often have you done these social activities online in the past month? Base: All children who use the internet.

Figura 2 tregon dy grafikë që ilustrojnë përgjigjet mbi një sondazh të përdorimit të internetit nga fëmijët për aktivitete sociale në internet në muajin e kaluar: Një tabelë ilustron ndarjen e përdorimit midis vajzave dhe djemve, me një përdorim të ngjashëm për djemtë dhe vajzat në çdo rast, përveç një rasti. Grafiku tjetër tregon ndarjen sipas grupmoshës. Kjo ilustron se në të gjitha vendet e anketuara, grupi i fëmijëve 9-11 vjeç përdorin internetin për aktivitete sociale në internet më rrallë se dy grupet e tjera (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç) dhe për çdo vend grupi i 15-17 vjeçarëve e përdorin atë më së shumti.

Shënim: Fëmijët dhe të rinjtë u pyetën se sa shpesh kishin bërë aktivitetet e mëposhtme shoqërore në internet gjatë muajit të kaluar: përdorën internetin për të biseduar me njerëz nga vende ose prejardhje të ndryshme nga

¹⁹ This figure was taken from: UNICEF (2019). *Growing up in a connected world*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence, <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/GKO%20Summary%20Report.pdf>,

ato; vizitoi një faqe në internet të rrjeteve sociale; bisedoi me familjen ose miqtë që jetonin më larg; mesazhe të menjëhershme të përdorura; morën pjesë në një faqe në internet ku njerëzit ndajnë interesat ose hobet e tyre.

Burimi: UNICEF

Është e qartë nga të dhënat e mësipërme se Interneti hap dimensione të reja për socializim, megjithëse prindërit shpesh ankohen se ndërveprimet në internet të fëmijëve dhe të rinjve pengojnë krijimin e raporteve personale në botën reale.

"Në një festë, ata janë ulur në një tavolinë. 10 prej tyre janë secili me pajisjet e tyre të vogla." Shprehet një prind i adoleshentëve të moshës 15-17 vjeç, në Kili

Një sjellje e tillë nuk është ekskluzive vetëm për fëmijët dhe të rinjtë. Disa prindër sillen po njësoj duke qënë vazhdimisht të zënë me telefonata apo në Internet gjatë mbledhjeve me shoqërinë dhe familjen - diçka që shqetëson shumë fëmijë dhe të rinj.

"Në tryezë, kur jemi duke ngrënë dhe babi përdor telefonin e tij. Kjo është koha e vetme kur jemi të gjithë së bashku dhe kjo me të vërtetë më bezdis." - Shprehet një vajzë 14 vjeç, në Uruguaj.

Me rritjen e aksesit në internet, fëmijët dhe të rinjtë mund të zgjerojnë horizontin e tyre, të mbledhin informacione dhe të forcojnë marrëdhëniet e tyre. Me më shumë ndërveprime shoqërore, si në internet apo në jetën reale, ata ndërtojnë përvojën dhe aftësitë e tyre. Hulumtimet e GKO tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë më aktivë në socializimin në internet janë më të mirë në menaxhimin e privatësisë së tyre në internet, gjë që i ndihmon për t'i mbajtur ata të sigurt.

Kënaqësia e të krijuarit

Disa nga përmbajtjet në internet që fëmijët dhe të rinjtë gjejnë dhe vlerësojnë janë krijuar nga vet bashkëmoshatarët e tyre.

Tipikisht, në 11 vendet e anketuara nga Global Kids Online, 10 deri në 20 përqind e fëmijëve dhe të rinjve krijojnë dhe ngarkojnë videon ose muzikën e tyre çdo javë, ose shkruajnë një blog, ose histori, ose krijojnë faqe në internet çdo javë.


"Unë kam një blog dhe e përditësoj rregullisht." - Shprehet një vajzë 15–17 vjeç, në Filipine.

Ju mund të ndani video dhe lojëra. Ju mund të ndani muzikë. Ju gjithashtu mund të shpërndani fotografi, ide, lojëra" - Shprehet një vajzë 9–11 vjeç, në Ganë.

"Unë bëj karta DIY; I postoj në internet. Miqtë e mi i pëlqejnë ato." - Shprehet një vajzë 15–17 vjeç, në Filipine.

"Po, unë di si të hackoj kompjutera, por nuk e bëj më." Shprehet një Djalë 15–17 vjeç, në Filipines.

Figura 3: Fëmijët (%) që kryejnë të paktën një aktivitet krijues çdo javë sipas gjinisë dhe moshës²⁰



Question C4m-n: How often have you done creative activities online in the past month? Note: In Uruguay, children were not asked about creating blogs online. Base: All children who use the internet.

Question C4m-n: How often have you done creative activities online in the past month? Note: In Uruguay, children were not asked about creating blogs online. Base: All children who use the internet.

Figura 3 tregon dy grafikë që ilustronjë përgjigje mbi një sondazh të përdorimit të internetit nga fëmijët për aktivitete krijuese në internet muajin e kaluar: Një tabelë ilustron ndarjen e përdorimit midis vajzave dhe djemve, me një përdorim të ngjashëm krijues për djemtë dhe vajzat. Grafiku tjetër tregon ndarjen sipas grupmoshës. Ky ilustron se në të gjitha vendet, përveç një prej të anketuarve, grupi i fëmijëve 9-11 vjeç përdori internetin për aktivitete krijuese në internet më rrallë se dy grupmoshat e tjera (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç) dhe për të gjithë, përveç njërit prej vendeve të anketuara, grupi i 15-17 vjeçarëve e përdorën atë më së shumti për krijimtari.

Shënim: Fëmijët dhe të rinjtë u pyetën se sa shpesh kishin bërë aktivitetet e mëposhtme krijuese në internet gjatë muajit të kaluar: krijuan videon ose muzikën e tyre dhe ndanë në internet; krijoj një blog ose histori ose faqe në internet; postuar video ose muzikë të krijuar nga dikush tjetër.

Burimi: UNICEF

Një dëshirë për informacion

Ashtu si të rriturit, fëmijët dhe të rinjtë po përfitojnë nga interneti për të ushtruar të drejtën e tyre për informacion. Midis një të pestës dhe dy të pestave të fëmijëve dhe të rinjve mund të konsiderohen 'kërkues të informacionit'. Pra ata kryejnë forma të shumfishta të kërkimeve të informacionit në internet çdo javë - për të mësuar diçka të re, për të mësuar rreth punës ose mundësive të studimit, për të parë lajme, për të marrë informacione shëndetësore ose për të mësuar mbi ngjarje në lagjen e tyre.

Shumë fëmijë dhe të rinj të të gjitha moshave përdorin internetin për detyrat e shtëpisë, apo edhe për të kapur ritmin e lëndëve të humbura.

“Ata na kërkuan të gjejmë emra të ministrave në Gana, për të kërkuar në lidhje me vendet dhe monedhat e tyre. Ju mund të merrni lajme për vendet e tjera”-Shprehet një vajzë, moshë 12-14 vjeç, në Gana.


²⁰ This figure was taken from: UNICEF (2019). *Growing up in a connected world*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence, <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/GKO%20Summary%20Report.pdf>.

"Në Internet, ne mund të kërkojmë të gjitha gjërat që na duhen për shkollën, të cilat nuk mund t'i gjejmë në libra." -Shprehet një vajzë 9 vjeç, në Serbi.

"Unë kam ngelur në matematikë, kështu që pashë disa video ku ata shpjegojnë se çfarë duhej të studioja." -Shprehet një djalë, moshë 15–17 vjeç, në Argjentinë.

"Nëse nuk shkoni në shkollë, ju mund të flisni me mikun tuaj dhe të zbuloni se çfarë keni humbur dhe gjëra të tjera. Pra, është e rëndësishme që të keni psh, ËhatsApp-in e mikut tuaj" -Shprehet një vajzë e moshës 16-17 vjeç, në Afrikën e Jugut.

Figura 4: Fëmijët (%) që kryejnë të paktën tre ose më shumë aktivitete të kërkimit të informacionit në javë, sipas gjinisë dhe moshës ²¹



Question C4: How often have you done information-seeking activities online in the past month? Base: All children who use the internet.

Question C4: How often have you done information-seeking activities online in the past month? Base: All children who use the internet.

Figura 4 tregon dy grafikë që ilustrojnë përgjigjet mbi një sondazh të përdorimit të Internetit nga fëmijët për aktivitete në kërkim të informacionit online muajin e kaluar: Një tabelë ilustron ndarjen e përdorimit midis vajzave dhe djemve, me një përdorim të ngjashëm për djemtë dhe vajzat. Grafiku tjetër tregon ndarjen sipas grupmoshës. Kjo ilustron se në të gjitha vendet, përveç një prej të anketuarve, grupi i fëmijëve 9-11 vjeç përdori internetin për aktivitete krijuese në internet më rrallë se dy grupmoshat e tjera (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç) dhe për të gjitha vendet e anketuara, grupi i 15-17 vjeçarëve e përdorën atë më së shumti për kërkimin e informacionit.

Shënim: Fëmijët dhe të rinjtë u pyetën se sa shpesh kishin bërë aktivitetet vijuese të kërkimit të informacionit në muajin e kaluar: mësuani diçka të re duke kërkuar në internet; kërkuan informacion në lidhje me mundësitë e punës ose të studimit; përdorën internetin për punë shkollore; kërkuan burime ose ngjarje në lidhje me lagjen e tyre lokale; panë lajmet në internet; kërkuan informacione shëndetësore për veten e tyre ose dikë që ata njohin. Argjentina është hequr për shkak të mungesës së të dhënave.

Burimi: UNICEF

Disa fëmijë dhe të rinj kanë tendencë të përdorin internetin më tepër se të tjerët për të kërkuar informacion. Të dhënat tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë që përdorin internetin për një gamë të gjerë të aktiviteteve të kërkimit të informacionit priren të kenë më shumë kohë që zhvillojnë aftësinë për t'u përfshirë me aktivitetet në internet dhe kanë prindër mbështetës dhe suportues ndaj përdorimit të Internetit. Ky rezultat indikon që ndërsa fëmijët dhe të rinjtë

²¹ This figure was taken from: UNICEF (2019). *Growing up in a connected world*. UNICEF Office of Research - Innocenti, Florence, <https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/GKO%20Summary%20Report.pdf>,

rriten me formën e duhur të mbështetjes prindërore, ata priren të fitojnë më shumë përvojë në internet dhe të përdorin internetin për të mirën e tyre.

Me kaq shumë informacion të disponueshëm në internet, fëmijët dhe të rinjtë duhet të kenë aftësitë e nevojshme për të gjetur përmbajtjen e duhur dhe për të kontrolluar mbi të vërtetën e asaj që zbulojnë.

Ekzistojnë disa ndryshime midis vajzave dhe djemve në këtë drejtim, me fëmijët dhe të rinjtë që bëhen më ekspertë në gjetjen e atyre që u nevojiten në internet gjatë viteve të tyre të adoleshencës. Fëmijët dhe të rinjtë që shohin më shumë videoklipe në internet duket se kanë aftësi më të mira për kërkimin e informacionit, kjo sepse mësojnë se si të gjejnë atë që u nevojitet duke kërkuar më shpesh përmbajtje në internet.

Cilësia dhe sasia e informacionit që fëmijët dhe të rinjtë mbledhin në internet varet nga interesat dhe motivimi i tyre. Por ajo që ata do të gjejnë do të ndikohet edhe nga shtrirja e informacionit në dispozicion, i cili do të jetë më i lartë për gjuhët më të folura. Akoma, pakicat mund të përfitojnë nga mundësitë e kërkimit të informacionit - edhe nëse janë më të kufizuar në numër.

"Ndonjëherë, pasi askush nuk flet gjuhën tonë në këtë shkollë, unë shkruaj diçka në Rumanisht në YouTube dhe dëgjoj zërin tonë, dhe kjo është mirë, unë mund t'i kuptoj të gjitha" – Shprehet një djalë rom 12 vjeç, në Serbi.

Është një gjë të jesh i aftë në kërkimin e informacionit në Internet dhe një gjë tjetër të jesh në gjendje të kontrollosh nëse informacioni i gjetur në internet është i vërtetë.

"Unë shikoj lajmet e huaja, sepse më pëlqen të shoh se si një vend po shikon një situatë dhe si një vend tjetër po shikon të njëjtën situatë. Sepse ka gjithmonë dy anë. Për shembull, Amerika mund të shohë diçka ndryshe dhe Rusia mund të shohë diçka ndryshe." – Shprehet një vajzë 16 vjeç, në Serbi.

Kur krahasohet me përqindjen e fëmijëve dhe të rinjve që raportuan se kishin aftësi të forta për të kërkuar informacion, kishte vetëm disa fëmijë dhe të rinj që thanë se ishin të mirë në vlerësimin kritik të informacionit që gjetën.

"Ka kaq shumë lajme të rreme në internet." – Shprehet një djalë 15 vjeç, në Filipine.

Në përgjithësi, fëmijët dhe të rinjtë nuk duket se po i shfrytëzojnë plotësisht mundësitë për kërkimin dhe kontrollin e informacionit në internet. Për ta bërë këtë, veçanërisht fëmijët e vegjël do të kenë nevojë për më shumë mbështetje, qoftë nga prindërit e tyre, nga shkollat apo nga ofruesit digjitalë, për t'i inkurajuar dhe ndihmuar ata që të ushtrojnë të drejtat e tyre në botën dixhitale.

Të qëniet qytetarë aktivë

Përtej kërkimit të informacionit dhe krijimit të përmbajtjes, fëmijët dhe të rinjtë mund të merren gjithashtu me veprimtari civile ose politike përmes internetit. Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, një fëmijë ka të drejta qytetare, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, për t'u shprehur dhe për të takuar të tjerët. Megjithatë është e qartë nga kërkimi Global Kids Online që relativisht pak fëmijë dhe të rinj po shfrytëzojnë mundësitë e angazhimit qytetar në internet.

Të rinjtë priren të angazhohen politikisht në internet.

"Politika... mbase ajo nuk e kërkon atë posaçërisht. Por vajza ime, për shembull, lexon për këtë në Facebook." – Shprehet një prind i fëmijës 13-14 vjeç, në Argjentinë

"Por ata gjithashtu japin mendimet e tyre... në Twitter ... dhe kjo e përfshin." – Shprehet një prind i fëmijës së moshës 15–17 vjeç, në Argjentinë.

Risqet dhe pësojat e dëmit

Fëmijët dhe të rinjtë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të reja kur janë në internet, gjë që mund t'i çojë ata në pasoja të rënda e serioze. Ata mund të hasin informacione se si të vetëdëmtohen ose të bëjnë vetëvrasje. Ata gjithashtu mund të ballafaqohen me gjuhë urrejtjeje ose materiale të një natyre të dhunshme ose seksuale. Sondazhi i kryer nga Global Kids Online në të gjithë vendet sugjeroi që fëmijët dhe të rinjtë që merren me një gamë më të gjerë të aktiviteteve në internet kishin përjetuar më shumë rreziqe në internet si pasojë e ekspozimit të tyre të shtuar ose eksplorimit të tyre më të sigurt në Internet.

Është e rëndësishme të kuptohet se rreziku jo gjithmonë çon në dëm. Fëmijët dhe të rinjtë e ekspozuar ndaj rreziqeve në internet mund të mos pësojnë dëm nëse kanë njohuri dhe qëndrueshmëri për të përballuar përvojën. Prandaj, është e rëndësishme të identifikohen se cilët prej tyre janë më të prekshëm ndaj pasojave në internet për të mbrojtur në mënyrë efektive fëmijët dhe të rinjtë në internet pa kufizuar mundësitë e tyre padrejtësisht.

Në përgjithësi, rreth 20 përqind e fëmijëve dhe të rinjve të anketuar nga Global Kids Online thanë se ata kishin parë vitin e kaluar faqe ose diskutime në internet rreth njerëzve që dëmtonin fizikisht ose dëmtonin veten, ndërsa rreth 15 përqind e fëmijëve dhe të rinjve shihnin përmbajtje në lidhje me vetëvrasjen. Ky anketim gjithashtu tregoi se fëmijët dhe të rinjtë ishin të ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes.

Në Kili, gjatë vitit të kaluar pothuajse gjysma e adoleshentëve në grupmoshën 15-17 vjeç raportojnë një ngjarje që ndodh në internet që i kishte shqetësuar ose bezdisur ata. Kur u pyetën për të elaboruar, ata përmendën një grup të gjerë çështjesh, duke përfshirë mashtrimet në Internet, reklamat pornografike të pop-up, sjelljet lënduese, lajmet e pakëndshme ose të frikshme, fotografite, diskriminimin dhe ngacmimet. Në Bullgari, fëmijët dhe të rinjtë ishin në rrezik nga faqet e internetit që promovojnë humbje të shpejtë të peshës, të cilat ishin parë nga një e katërta e të anketuarve.

"Ka komente të shëmtuara për njerëzit e tjerë"-shprehet një vajzë e moshës 13-14 vjeç, në Afrikën e Jugut.

Rreth një e katërta dhe një e treta e fëmijëve dhe të rinjve të anketuar mbi çështjen ishin ballafaquar me përmbajtje të dhunshme në internet ose përmbajtje seksuale në çdo formë të medias. Ndonjëherë fëmijët dhe të rinjtë hasnin rastësisht në përmbajtjen e një natyre seksuale; në raste të tjera, miqtë kishin rekomanduar përmbajtje seksuale ose u ishin dërguar nga të tjerët, përfshirë të panjohur. Disa fëmijë dhe të rinj kishin kërkuar imazhe seksuale nga të tjerët.

"Unë u mërzita me të vërtetë kur djali më dërgoi foto pornografike."-shprehet një vajzë 12–14 vjeç, në Ganë.

"Një herë kam përjetuar rastin e një të huaji duke kërkuar "çmimin tim"- që do të thotë sa do të kushtonte për të kryer një marrëdhënie seksuale."-shprehet një djalë 16 vjeç, në Filipine.

Në disa vende, shumë fëmijë dhe të rinj kanë përjetuar një sërë rreziqesh në internet, por shumë më pak raportojnë se ndihen të dëmtuar si rezultat. Rezultatet ndryshojnë në varësi të vendit dhe të rinjtë kanë zakonisht më shumë mundësi të përjetojnë dëm sesa fëmijët më të vegjël. Një arsye mund të jetë sepse ata kalojnë më shumë kohë në internet dhe kanë tendencë të përfshihen në një gamë më të gjerë të aktiviteteve në internet.

"Isha në Instagram dhe klikova në një koment dhe ishte aq qesharak, kështu që doja të shihja se çfarë kishin për të thënë të tjerët dhe klikova në një link dhe papritmas u shfaqën gra të zhveshura"-shprehet një djalë 10 vjeç, në Serbi.

"Unë i dua kuajt, të gjithë e dinë këtë. Po kërkoja për disa fotografi për sfondin tim dhe u gjenda në një fotografi të tmerrshme të një burri që preu një kal. "-shprehet një vajzë 10 vjeç, në Serbi.

"Unë isha shumë i frikësuar, pashë një foto të një djali që u qëllua për vdekje"-shprehet djali 12-14 vjeç në Gana.

Figura 5: Fëmijët (%) që kanë përjetuar dëm në internet, sipas gjinisë dhe moshës²²




Figura 5 tregon dy grafikë që ilustrojnë përgjigje mbi një sondazh të përdorimit të Internetit nga fëmijët për diçka në internet që i ka shqetësuar ose mërzitur - i bëri ata të ndjehen të bezdisur, të frikësuar ose që nuk duhet ta kishin parë. Një tabelë ilustron ndarjen e përdorimit midis vajzave dhe djemve, me një përqindje të ngjashme për djemtë dhe vajzat.

Grafiku tjetër tregon ndarjen sipas grupmoshës. Kjo ilustron se në të gjitha vendet, përveç një nga vendet e anketuara, grupi i fëmijëve 9-11 vjeç që raportojnë incidente më rrallë se dy grupmoshat e tjera (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç), dhe për të gjithë vendet e anketuara me një përjashtim, grupi i 15-17 vjeçarëve raportoi më së shumti incidente.

Burimi: UNICEF

Fëmijët dhe të rinjtë mund të keqtrajtohen në mënyra të ndryshme si në internet dhe offline. Në platformat në internet, dëmtimi mund të shkaktohet ose nga mesazhe të dëmshme, duke u përjashtuar nga aktivitetet në grup ose duke u kërcënuar. Këto përvoja shpesh cilësohen si 'ngacmim në internet' i referuar ndryshe si bullizëm kibernetik. Por fëmijët dhe të rinjtë mund të lëndohen gjithashtu në mënyrë të ngjashme në ndërveprimet e tyre të përditshme offline. Përqindje të barabarta të fëmijëve dhe të të rinjve që ngacmohen nga të tjerët e përjetojnë këtë personalisht dhe në internet.

²² This figure was taken from: Global Kids Online (2019). Global Kids Online: Comparative Report, UNICEF Office of Research – Innocenti.

"Të gjithë filluan të ngacmonin dhe të talleshin me një djalë. Ai përfundoi duke u larguar nga grupi." – shprehet një djalë 13-14 vjeç, në Argjentinë.

"Jam i shqetësuar për ngacmimin në internet sepse mund të më shkaktojë shumë dëme emocionale." – shprehet një vajzë 14 vjeç, në Uruguaj.

Si i përgjigjen fëmijët dhe të rinjtë përvojave të dëmshme në internet? Fillimisht, ata u drejtohen miqve ose vëllezërve të tyre. Më pas ata mund t'u tregojnë prindërve të tyre. Shumë pak fëmijë dhe të rinj në vendet e anketuara kërkojnë mbështetje nga mësuesit e tyre. Edhe pse të rinjtë hasin më shumë rreziqe sesa fëmijët më të vegjël, ata nuk vuajnë nga dëme përkatësisht më të mëdha - duke sugjeruar që me përvojën të vijë edhe qëndrueshmëria.

Vlen të përmendet se fëmijët dhe të rinjtë nuk i njohin gjithmonë termat 'online' dhe 'offline' si hapësira të dallueshme. Për fëmijët dhe të rinjtë, përvojat në internet - qofshin të mira apo të këqija - ndërthuren me aspektet e tjera të jetës së tyre.

Privatësia është prioritet

Privatësia është e drejtë e një fëmije, sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Është e rëndësishme për arritjen e autonomisë dhe vetëvendosjes dhe është e ndërlidhur me të drejtën e fëmijës për informacion, lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen. Fëmijët dhe të rinjtë mund të mbrojnë veten nga shfrytëzimi duke mbrojtur privatësinë e tyre. Ata duhet të menaxhojnë me kujdes identitetet e tyre digjitale dhe të mbrojnë të dhënat e tyre personale sa më shumë që të jetë e mundur.

Shumë fëmijë dhe të rinj raportojnë aftësi të forta të privatësisë në menaxhimin e marrëdhënieve të tyre ndërpersonale në internet - për shembull, ata janë të vetëdijshëm për informacionin që duhet dhe nuk duhet të ndajnë në internet ose ata dinë si të ndryshojnë cilësimet e tyre të privatësisë së mediave sociale ose të heqin njerëzit nga listat e tyre të kontaktit. Ky rezultat pasqyron që përpjekjet e hershme për të promovuar sigurinë e internetit midis fëmijëve dhe të rinjve kanë qenë mjaft të suksesshme. Shumë fëmijë dhe të rinj kanë zhvilluar strategji për të mbrojtur veten në internet dhe janë të vetëdijshëm se duhet të marrin në konsideratë rreziqe të caktuara kur përdorin internetin.

"Unë kam një llogari në Facebook për miqtë e mi të vërtetë dhe një tjetër për miqtë që sapo takoj në internet." - shprehet një vajzë, 14 vjeç, në Filipine.

"Kur jam i lidhur në internet, unë vetë jam përgjegjës për atë që bëj." -shprehet një vajzë 17 vjeç, në Uruguaj.

Është problematike kur fëmijët dhe të rinjtë në internet mund t'i ekspozojnë informacionet, fotografitë dhe komunikimet e tyre private ndaj abuzimeve të mundshme dhe kontakteve të papërshtatshme dhe të padëshiruara.

Fëmijët dhe të rinjtë gjithashtu mund të kontaktojnë me njerëz në internet të cilët më pas i takojnë personalisht, megjithëse kjo ende mbetet relativisht e rrallë. Më pak se një e katërta e fëmijëve dhe të rinjve në të gjitha vendet kanë takuar dikë ballë për ballë me të cilin ishin njohur për herë të parë në internet.

Ndoshta çuditërisht, fëmijët dhe të rinjtë më së shumti i shijojnë këto takime ballë për ballë dhe raportojnë se ndihen të lumtur më pas - duke sugjeruar se në këtë mënyrë ata po përfitojnë nga rritja e rrethit të tyre të miqve. Nga ana tjetër, edhe në numrin e vogël të rasteve kur fëmijët dhe të rinjtë raportojnë se janë mërzitur nga këto takime, ka një shkak për shqetësimin e tyre.

Prindërit që shpërndajnë përmbajtje të fëmijëve të tyre duhet të marrin parasysh se si kjo mund të ndikojë tek fëmija. Ekzistojnë shqetësime se 'shpërndarja' (prindërit që ndajnë informacione dhe fotografi të fëmijëve të tyre në internet) mund të shkelë privatësinë e fëmijës, të çojë në ngacmim, të shkaktojë siklet ose të ketë pasoja negative më vonë në jetë. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara mund të ndajnë informacione të tilla në kërkim të një ndihme ose këshille, duke i vendosur fëmijët me aftësi të kufizuara në rrezik më të lartë për rezultate të padëshiruara.

Shtëpia është aty ku është Wi-Fi

Një mënyrë për të siguruar që rreziqet në internet nuk rezultojnë në dëm të fëmijëve dhe të rinjve është përmirësimi i udhëzimeve mbi përdorimin e internetit nga ta për prindërit etj.


"Të rriturit kanë shumë ndikim tek të rinjtë dhe duhet të japin një shembull të mirë për të ndjekur." Vajzë, 13 vjeç, Uruguaj.

Në parim, prindërit kanë një pozitë të fortë për të mbështetur përdorimin e internetit nga fëmijët e tyre duke qënë që fëmijët dhe të rinjtë kryesisht aksesojnë internetin në shtëpi.

Por duke qënë në përballje me teknologji komplekse dhe me zhvillim të shpejtë, shumë prindër nuk ndihen mjaftueshëm të sigurt ose të aftë për të mbikëqyrur fëmijët e tyre dhe të rinjtë, në dukje më të adaptuar të teknologjisë. Prindërit gjithashtu ndikohen nga shqetësimet e zakonshme mbi 'kohën e ekspozuar ndaj ekranit', 'varësinë nga interneti' dhe 'rrezikun e huaj'. Prandaj veprimi i parë i tyre është në fakt kufizimi i fëmijëve të tyre në përdorimin e internetit, për shembull, duke kufizuar kohën e tyre në internet ose duke ndaluar përdorimin e pajisjeve digjitale në dhomat e gjumit, gjatë vakteve ose pas gjumit- në krahasim me mundësimin ose udhëzimin e tyre për të marrë pjesë në mënyrë më produktive në internet.

Në shumicën e vendeve, prindërit janë më të përfshirë në përdorimin e internetit të fëmijëve më të vegjël, duke i ndihmuar ata të lundrojnë në hapësirën digjitale, ndërsa në të njëjtën kohë u imponojnë më shumë kufizime sesa të rinjve. Ata priren të ndërhyjnë më pak ndërsa fëmijët e tyre rriten, edhe pse adoleshentët me siguri do të përfitonin ende nga udhëzimet konstruktive të prindërve mbi mundësitë në internet, si dhe rreziqet.

Figura 6: Fëmijët (%) që përdorin Internetin në shtëpi çdo javë, sipas gjinisë dhe moshës²³



Question B6b: Use of internet at home at least weekly.
Base: All children who use the internet.

Question B6b: Use of internet at home at least weekly.
Base: All children who use the internet.

Figura 6 tregon dy grafikë që ilustrojnë përgjigjet për një sondazh të përdorimit të internetit nga fëmijët në shtëpi të paktën çdo javë. Një tabelë ilustron ndarjen e përdorimit midis vajzave dhe djemve, me një përqindje të ngjashme për djemtë dhe vajzat në të gjitha vendet. Grafiku tjetër tregon ndarjen sipas grupmoshës. Kjo ilustron se në shumicën e vendeve të anketuara, grupi i fëmijëve 9-11 vjeç kanë qasje po aq sa dy grupmoshat e tjera (12-14 vjeç dhe 15-17 vjeç), dhe për të gjitha vendet e anketuara me një përjashtim, grupi i 15-17 vjeçarëve raportoi më shumë akses.

Burimi UNICEF

Një arsye pse një prind heziton të përfshihet në përdorimin e internetit të fëmijëve dhe të rinjve është se ata vetë kanë mungesë të ekspertizës.

4. Fëmijët vulnerabël

Fëmijët dhe të rinjtë mund të jenë të prekshëm për një sërë arsyesh të ndryshme. Huluntimi i kryer në 2019²⁴ deklaroi "se jeta digjitale e fëmijëve të pambrojtur rrallë merr të njëjtën nuancë vëmendjeje ashtu sikurse ka tendencë të tërheqë fatkeqësia e 'jetës reale'. Për më tepër, raporti vazhdon duke thënë se në rastin më të mirë ata [fëmijët dhe të rinjtë] marrin të njëjtën këshillë të përgjithshme për sigurinë në internet si të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e tjerë, ndërkohë që duhet të kërkohet ndërhyrje nga specialistët".

Megjithëse tre shembujt e dobësive specifike janë theksuar këtu, (fëmijët emigrantë, fëmijët me çrregullime të spektrit autik dhe fëmijët me aftësi të kufizuara), ka edhe shumë të tjerë.

Fëmijët emigrantë

Fëmijët dhe të rinjtë emigrantë vijnë shpesh në një vend (ose tashmë jetojnë atje) me një grup të veçantë të përvojave dhe prirjeve socio-kulturore. Ndërsa teknologjia zakonisht mendohet të jetë një katalizator për tu lidhur dhe marrë pjesë në shoqëri, rreziqet dhe mundësitë në

²³ This figure was taken from: Global Kids Online (2019). Global Kids Online: Comparative Report, UNICEF Office of Research – Innocenti.

²⁴ Adrienne Katz (2018), Vulnerable Children in a Digital World, <https://pwxp5srs168nsac2n3fnjyaa-wpengine.netdnassl.com/wp-content/uploads/2019/02/Vulnerable-Children-in-a-Digital-World-FINAL.pdf>.

internet mund të ndryshojnë shumë sipas kontekstit. Për më tepër, gjetjet dhe hulumtimet empirike²⁵ tregojnë një funksion jetësor të mediave digjitale në përgjithësi:

- Është e rëndësishme për orientim (kur udhëtohet në një vend të ri).
- Është një funksion qëndror për përvetësimin dhe njohjen me shoqërinë / kulturën e vendit pritës.
- Mediat sociale mund të luajnë një rol kryesor në mbajtjen e kontakteve me familjen dhe bashkëmoshatarët dhe në qasjen ndaj informacionit të përgjithshëm. Krahas shumë aspekteve pozitive, media digjitale mund të sjellë sfida për emigrantët duke përfshirë:
 - Infrastrukturën - është e rëndësishme të mendohet për hapësira të sigurta në internet në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë emigrantë të mund të përfitojnë nga privatësia dhe siguria.
 - Burimet - emigrantët shpenzojnë shumicën e parave të tyre në kartat e parapaguara të telefonit.
 - Integrimi - së bashku me aksesin në teknologji, fëmijët dhe të rinjtë emigrantë gjithashtu duhet të marrin një arsimim të mirë digjital.

Fëmijët me Çrregullim të Spektrit Autik (ASD)

Spektri i autizmit përmbledh dy fusha thelbësore në procesin e diagnostikimit të sjelljes DSM-5²⁶.

- Sjellje e kufizuar dhe e përsëritur (nevoja për njëllojshmëri).
- Vështirësi në sjelljet shoqërore dhe komunikuese.
- Ngjarje të shpeshta të paaftësisë intelektuale, probleme gjuhësore etj.

Teknologjia dhe interneti ofrojnë mundësi të pafundme për fëmijët dhe të rinjtë kur mësojnë, komunikojnë dhe luajnë. Sidoqoftë, krahas këtyre përfitimeve ka shumë rreziqe ndaj të cilave fëmijët dhe të rinjtë me ASD mund të jenë më të prekshëm, siç janë:

- Interneti mund t'u japë fëmijëve dhe të rinjve me autizëm mundësi socializimi dhe interesash të veçanta që ata mund të mos i kenë offline.
- Sfidat sociale, të tilla si një vështirësi për të kuptuar qëllimet e të tjerëve, mund ta lënë këtë grup të prekshëm ndaj 'miqve' me qëllime dashakeqëse.
- Sfidat në internet shpesh janë të lidhura me karakteristikat thelbësore të autizmit: udhëzime konkrete, specifike mund të përmirësojnë përvojat në internet të individëve, por sfidat themelore sërish mbeten të pranishme.

²⁵ Better Internet for Kids (2017), Report on the proceedings of the Safer Internet Forum 2017,

<https://www.betterinternetforkids.eu/documents/167024/1738388/Report+on+the+proceedings+of+the+Safer+Internet+Forum+2017/fa4db409-4fae-45b1-96ec-35943b7d975d>

²⁶ Cardwell C. Nuckols (2013), *The Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders*, https://dhss.delaware.gov/dsamh/files/si2013_dsm5foraddictionsmhandcriminaljustice.pdf.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Sipas disa prej hulumtimeve të para këshilluese mbi përvojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në mjedisin digjital, këta fëmijë menduan se, në shumë mënyra, jeta e tyre digjitale ishte shumë e ngjashme me ato të fëmijëve normalë (pa aftësi të kufizuara). Sidoqoftë, kishte një numër ndryshimesh të dallueshme dhe të rëndësishme.²⁷ Ndërsa i konsiderojmë këto, është e rëndësishme të mbahet parasysh se sfidat dhe pengesat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara ndryshojnë ndjeshëm, sipas llojit dhe natyrës së dëmtimit. Nevojat e tyre të veçanta duhet të merren parasysh mbi të dhëna individuale.²⁸

Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen me rreziqe në internet në mënyra të ngjashme me fëmijët dhe të rinjtë pa aftësi të kufizuara, por ata gjithashtu mund të përballen me rreziqe specifike në lidhje me aftësitë e tyre të kufizuara. Ata kanë 12 përqind më shumë mundësi të kenë përjetuar ngacmim në internet në krahasim me fëmijët dhe të rinjtë pa aftësi të kufizuara. Disa fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara mund të jenë më pak të aftë në menaxhimin e marrëdhënieve të tyre ndërpersonale në internet ose të bëjnë dallimin midis informacionit të vërtetë dhe të rremë. Disa mund të manipulohen lehtësisht në shpenzimin e parave, ndarjen e informacionit të papërshtatshëm, etj. Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara shpesh përballen me përjashtim, stigmatizim dhe pengesa (fizike, ekonomike, shoqërore dhe përbuzjeje) në pjesëmarrjen në komunitetet e tyre. Këto përvoja mund të kenë një ndikim negativ tek një fëmijë me aftësi të kufizuara që kërkon ndërveprime shoqërore dhe miqësi në hapësira në internet, të cilat nga ana tjetër mund të jenë pozitive, të ndihmojnë në ndërtimin e vetëvlerësimit dhe të krijojnë rrjete mbështetëse. Sidoqoftë, ai gjithashtu mund t'i vendosë ata në rrezik më të lartë për incidente pedofilie dhe/ose ngacmimi seksual. Hulumtimet tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë që përjetojnë vështirësi në aktivitetet offline dhe ata që preken nga vështirësi psikosociale janë në rrezik shumë më të lartë ndaj incidenteve të tilla.²⁸

Pedofilët dhe/ose personat që kryejnë ngacmimin seksual ndaj fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara mund të përfshijnë jo vetëm shkelës të privilegjuar të cilët targetojnë fëmijë dhe të rinj, por edhe ata që targetojnë fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara. Njerëz të tillë mund të përfshijnë 'të fiksuar' - persona me çrregullime të tërhequr seksualisht ndaj personave me aftësi të kufizuara (më së shpeshti personat e gjymtuar dhe personat që përdorin ndihmat e lëvizjes). Disa prej tyre pretendojnë të jenë dhe vet me aftësi të kufizuara.²⁹ Veprimet nga njerëz të tillë mund të përfshijnë shkarkimin e fotove dhe videove të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara (me natyrë të padëmshme) dhe/ose ndarjen e tyre përmes forumeve të dedikuara ose llogarive të mediave sociale. Raportimi në forume dhe media sociale shpesh nuk kanë një rrugë të përshtatshme për t'i zgjidhur veprime të tilla.

²⁷ Lundy et al. (2019), *TWO CLICKS FORWARD AND ONE CLICK BACK: Report on children with disabilities in the digital environment*, <https://rm.coe.int/two-clicks-forward-and-one-click-back-report-on-children-with-disabili/168098bd0f>^{disabili/168098bd0f}.²⁸ ibid.

²⁸ Andrew Schrock et al. (2008), *Solicitation, Harassment, and Problematic Content*, https://cyber.harvard.edu/sites/cyber.law.harvard.edu/files/ISTTF-LitReviewDraft_0.pdf.

²⁹ Richard L Bruno (1997), *Devotees, Pretenders and Wannabes: Two Cases of Factitious Disability Disorder, Sexual and Disability*, <https://link.springer.com/content/pdf/10.1023/A:1024769330761.pdf>.

Disa fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara mund të përballen me vështirësi në përdorim, apo të ndjehen të përjashtuar në hapësirat në internet për shkak të dizajnit të paarritshëm (p.sh. aplikacione që nuk lejojnë rritjen e madhësisë së tekstit), mohimit të akomodimeve të kërkuara (p.sh. softuer i lexuesit të ekranit ose kontrole adaptive të kompjuterit), ose nevoja për mbështetje të përshtatshme (p.sh. trajnimi në mënyrën e përdorimit të pajisjeve, suport hap pas hapi për të lundruar në ndërveprimet sociale).³⁰

Disa prindër të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara mund të jenë shumë striktë dhe kufizues për shkak të mungesës së njohurive se si ta drejtojnë më mirë përdorimin e internetit të fëmijës së tyre ose t'i mbrojnë ata nga bullizmi ose ngacmimi.³² Disa prindër të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara mund të ndajnë informacione ose media (foto, video) e fëmijës së tyre në ndjekje të mbështetjes ose këshillimit, duke e vendosur fëmijën e tyre në rrezik për shkelje të privatësisë si tani ashtu edhe në të ardhmen. Kjo gjithashtu mbart rrezikun që prindër të tillë të vihen në shënjestër nga njerëz të painformuar ose të paskrupullt që ofrojnë trajtime, terapi ose 'kura' për paaftësinë e fëmijës së tyre.³¹

5. Rreziqe dhe sfida të reja

Internet of Things

Interneti ka ndryshuar mënyrën e të jetuarit të njerëzve. Ai siguron akses në tërësinë e njohurive njerëzore në çdo kohë dhe kudo. Për disa njerëz, jeta është shumë më e lehtë dhe më shumë "komode" sesa ka qenë ndonjëherë. Por kjo zhvendosje, ky ndryshim ka shkatërruar gjithashtu disa nga stilet tradicionale të jetesës si në biznes, ashtu dhe në jetën personale. Për shembull, disa modele të mëparshme biznesi kanë ndryshuar plotësisht ose janë bërë inefektive ndërsa, në aspektin personal, ndërveprimet dhe komunikimi ballë për ballë duket se janë zvogëluar nga zhvillimi i Internetit.

Është e rëndësishme të merret parasysh Interneti i hapur (open Internet) dhe Internet of Things: Interneti i hapur (Open Internet) është vetëm virtual; nuk ekziston në realitetin e përditshëm dhe është në zgjedhjen tonë nëse duam të kemi interaktivitet me të. Nuk është e njejtja gjë me Internet of Things ku objektet fizike janë të lidhura ngushtë me përdorimin e internetit, me qëllim përmirësimin e jetës tonë— [tweeting toaster](#) është vetëm një nga shumë shembuj të tillë!

Mundësitë e Internet of Things (IoT) janë të panumërta. Tashmë IoT është i disponueshëm në veshje, dritat në shtëpi, kamera, makina, tualete, paketime, matësit e energjisë, sensorët mjekësorë... lista është e pafundme. IoT ka potencialin të ndryshojë gjithçka për mirë. Në të vërtetë, disa individë e konsiderojnë atë si pjesë të "Revolucionit të Katërt Industrial".

³⁰ UNO (2008), *Convention on the Rights of Persons with Disabilities and Optional Protocol*, <https://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>. For guidelines on these rights, see Article 9 on Accessibility and Article 21 on Freedom of expression and opinion, and access to information ³² Lundy et al. (2019), *TWO CLICKS FORWARD AND ONE CLICK BACK: Report on children with disabilities in the digital environment*, <https://rm.coe.int/two-clicks-forward-and-one-click-back-report-on-children-with-disabili/168098bd0f>.

³¹ Sonia Livingstone et al. (2019), *UNICEF Innocenti Research Brief: Is There a Ladder of Children's Online Participation?*, https://www.unicef-irc.org/publications/pdf/IRB_2019-02%2013-2-19.pdf.

Kur këto sende përdoren në afërsi të fëmijëve (dmth në shtëpitë e tyre) ata mund të ekspozohen ndaj rreziqeve që lidhen me përdorimin e veshjeve inteligjente, të cilat potencialisht mund të ndajnë vendndodhjen e tyre.

Ka mundësi masive të tregut. Sidoqoftë, ka edhe disa probleme të mundshme:

Probleme teknike/privatësie

- Siguria e pajisjes - siguria e duhur mund të jetë relativisht e shtrenjtë; e dyshimtë për viruse/malware.
- Siguria e komunikimit- enkriptimi është më i dobët pasi energjia është faktori kufizues. Mund të manipulohet nga palë të treta/hajdutëve të identitetit etj.
- Komunikimet Always-On (të përhershme) - ekziston një besueshmëri gjithnjë e më e lartë për pajisje që mbështeten në komunikime Always-On (të përhershme).
- Siguria e të dhënave në Cloud- realisht nuk dihet se cili po i përdor të dhënat tuaja

Probleme Sociale

- Përfshirja e njerëzve.
- Abuzim potencial i të dhënave.
- Potencial që teknologjia të lehtësojë situata të brendshme abuzimi.³²

Probleme Ekonomike

- Humbje e vendit të punës.

Probleme Mjedisore

- Ndotje në cdo stad (50 bilion pajisje në 5 vitet e ardhshme).

Lojra të lidhura me internet dhe robotika

Me zhvillimin e teknologjisë, falë zbulimit të "Internet of Toys", ka pasur ndryshime thelbësore në jetën njerëzore, ndryshime këto që ndikojnë jo vetëm tek të rriturit, por edhe tek fëmijët dhe të rinjtë. Ndërsa gjithnjë e më shumë aspekte të jetës sonë transformohen në të dhëna të kompjuterizuara, duhet të merren në konsideratë mënyra mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe t'u ofrohen mundësi për tu rritur në një botë dixhitale të sigurt.

Opinionet mbi robotikën kanë ndryshuar dhe ka pasur mjaft debate rreth "robotifikimit" të fëmijërisë. Dikur shihej si e rrezikshme për industrinë dhe një kërcënim për punën në mjediset e fabrikave, robotët kanë evoluuar. Ata janë të sofistikuar, suportues dhe shoqëror, dhe diçka me të cilën mund të ketë ndërveprim në shtëpi dhe në kohën e lirë. Ndërsa lodrat prej kohësh janë modeluar si robotë, ka pasur ndryshime të jashtëzakonshme që i bëjnë robotët më të

³² Julie Inman Grant, 2019, When "smart" is not necessarily safe: the rise of connected devices extending domestic violence, <https://www.esafety.gov.au/about-us/blog/when-smart-not-necessarily-safe-rise>
<https://www.esafety.gov.au/about-us/blog/when-smart-not-necessarily-safe-rise-connected-devices-extending-domestic-violence>

sofistikuar. Ata nuk marrin më vetëm formën klasike të trillimit shkencor robotik, por tani vijnë në jetë si lodra me këmbë, të cilat flasin dhe mendojnë.

Janë krijuar disa ndryshime të rëndësishme teknologjike në lidhje me fenomenin e **robotifikimit**, të cilat mund të pëmblihen si më poshtë:

- Rritje eksponenciale në fuqi kompjuterike.
- Lidhje celulare.
- Datafication and networked information-Transformimi i objekteve, praktikave në të dhëna dixhitale
- Kthimi i sensorëve, mikrofonave dhe kamerave në miniaturë.
- Robotic cloud computing.
- Progres në inteligjencën artificiale dhe machine learning.

Ndoshta një nga robotët më të zakonshëm me të cilët fëmijët dhe të rinjtë ndërveprojnë sot është Siri; zbavitëse aq sa mund të jetë një bisedë me një asistent dixhital, tregon thellësinë e zhvillimit të inteligjencës artificiale (AI) dhe algoritmeve që e drejtojnë atë. Një robot social mund të shpjegohet si: "Një pajisje artificiale dhe e mishëruar që mund të ndiejë mjedisin e saj (*shoqëror*) dhe ka si qëllim ndërveprimin në mënyrë autonome dhe me prosperitet me (*agjentët*) mjedisin duke ndjekur rregullat shoqërore të cilat, i janë bashkangjitur rolit të saj". Robotët socialë mund të jenë veçanërisht tërheqës për fëmijët dhe të rinjtë pasi janë adaptuesit e parë të teknologjive e reja dhe shpesh janë të targetuar edhe si përdorues të tillë. Si përfundim, fëmijët dhe të rinjtë zakonisht kanë interesa në zhvillim, por shumë të ndara dhe të përhapura. Për pasojë, ata janë ndoshta më të ndjeshëm ndaj efekteve të ndërveprimit me robotët.

Karakteristikat tipike të ndërveprimit fëmijë-robot përfshijnë:

- Lëvizshmëria.
- Ndërveprimi/reciprociteti.
- "Natyralizimi" (fjalët, gjestet dhe vizioni më shumë se të shkruarit).
- Rregullimi i ndërveprimit.
- Personalizimi.

Ndërsa proceset pasqyrojnë:

- Antropomorfizmin (shfaqja e karakteristikave ose sjelljes njerëzore).
- Praninë shoqërore.
- Përfshirjen
- Ngjashmërinë e perceptuar.

Ekzistojnë një sërë pasojash të mundshme për zhvillimin e njohurive të fëmijëve dhe të rinjve, të cilat burojnë nga ndërveprimi i tyre me robotët, qoftë ky ndërveprim pozitiv apo negativ. Rezultatet pozitive përfshijnë përmirësimin e të nxënit, i cili personalizohet tek fëmijët, përditësohet vazhdimisht dhe lehtëson vetë-mësuarjen. Rezultatet më pak pozitive burojnë nga Educational bubbles "*fluskat arsimore*" të cilat janë të ngjashme me "*fluskat e filtrit*" në internet kur përmbajtja është e kufizuar. Në raste të tilla, ekziston rreziku i fragmentizimit të njohurive të fëmijëve dhe paraqitja e një numri të madh të fakteve, ndërsa stili i

mësimdhënies bazohet thjesht në të mësuarin e algoritmave. Për shembull, kur një fëmijë i bën Alexa-s një pyetje (aq sa mund t'i bëhet një pyetje Google ose Bing), ata marrin vetëm një përgjigje, duke e bërë të vështirë vlerësimin në mënyrë kritike të përmbajtjes me të cilën janë ndeshur.

Shqetësime të ngjashme vlejné edhe për zhvillimin e identitetit të fëmijës. Studime të bazuara në kërkime ³³ kanë treguar se robotët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijëve dhe të rinjve duke i ndihmuar ata të zgjerojnë dhe përmirësojnë kërkimin e identitetit gjatë adoleshencës. Sidoqoftë, robotët vendosin në dukje çështje të privatësisë dhe ekziston rreziku që ato të përdoren si makineri mbikëqyrëse për shembull, duke i përdorur ato për të regjistruar këdo në afërsi të saj dhe kështu ngrihen shqetësime të rëndësishme mbi sigurinë si për prindërit, ashtu edhe për fëmijët dhe të rinjtë.

Kur bëhet fjalë për aspektet relacionale, marrëdhëniet me robotët mund të mos reflektojnë gjithmonë marrëdhëniet reale në jetë. Nga njëra anë, kjo mund të bëjë që fëmijët dhe të rinjtë të izoloohen nga shoqëria, duke gjetur komfort në një algoritëm që e qetëson dhe e ngushëllon atë. Por, kjo mund të nënkuptojë gjithashtu që robotët mund të sigurojnë një tërheqje për të "diskutuar" gjërat që janë të vështira për t'u biseduar me prindërit dhe bashkëmoshatarët. Marrëdhënia jonë me robotët do të jetë gjithmonë një marrëdhënie shërbëtor/zotëri, por robotët gjithnjë e më shumë mund të "pretendojnë se kanë ndjenja" dhe prandaj, fëmijët dhe të rinjtë mund të bien në grackën e të ndjerit të kësaj marrëdhënieje si autentike dhe reciproke. Siç deklaroi Jochen Peter, "Robotët kanë më shumë për të ofruar sesa lodrat tradicionale por ato gjithashtu paraqesin rreziqe masive për përdoruesit më të rinj".³⁴

Lojrat Online

Industria e lojërave ka tejkaluar si filmat ashtu edhe muzikën për sa i përket klientëve dhe të ardhurave. Për më tepër, me zhvillimin e lojërave celulare të cilat mund të aksesohen në një pajisje të vogël mobile, shumë njerëz luajnë lojëra më shumë se kurrë më parë. The State of Online Gaming 2019 thekson se 51.8% janë përdorues meshkuj dhe 48.2% janë femra, bazuar në përgjigjet e 4 500 konsumatorëve në Francë, Gjermani, Indi, Itali, Japoni, Singapor, Republikën e Koresë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, moshë 18 vjeç e lart, të cilët luajnë video lojëra të paktën një herë në javë.³⁵ 21% të lojtarëve të video lojërave janë nën 18 vjeç në Shtetet e Bashkuara të Amerikës që nga viti 2010.³⁶

Kërkimet e fundit në Francë, Gjermani, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar zbuluan se 54 përqind nga të gjithë ata lojtarë të moshës midis 6 dhe 64 vjeç luajnë video lojëra me 77 përqind të atyre që luajnë të paktën një orë në javë. Për më tepër, tre të katërtat e fëmijëve nga 6 deri në 15 vjeç në Gjermani, Spanjë, Itali, Mbretërinë e Bashkuar dhe Francë janë lojtarë të video lojërave, këto zënë mbi 24 milion në të pestë tregjet evropiane të GameTrack. Ata

³³ Van Straten, C. L., Peter, J., & Kühne, R. (2019). Child-robot relationship formation: A narrative review of empirical research. *International Journal of Social*

³⁴ Van Straten, C. L., Peter, J., & Kühne, R. (2019). Child-robot relationship formation: A narrative review of empirical research. *International Journal of Social*

³⁵ Limelight Networks (2019), *Market Research: The State of Online Gaming*,

http://img03.en25.com/Web/LLNW/%7B02ca9602-173c-43a4-9ee1-b8980c1ea459%7D_SOOG2019_MR_8.5x11.pdf.

³⁶ Statista.com (2019), *U.S. Average Age of Video Gamers in 2019 | Statista*,

<https://www.statista.com/statistics/189582/age-of-us-video-game-players-since-2010/>.

luajnë në një larmi pajisjesh, por rreth 7 në 10 lojtarë luajnë në konsolë ose pajisje inteligjentes³⁷

Në të gjithë botën, ka më shumë se 2.5 miliardë përdorues të video lojërave. Loja PUBG kapi pikun më të lartë të lojtarëve me 3 milion lojtarë në 1 orë.³⁸

Një nga platformat kryesore për të parë përmbajtjen e videolojërave në të gjithë botën është Twitch, e cila llogariti 54 përqind të të ardhurave nga platforma e përmbajtjeve të video lojërave në 2017.

Blerjet e lojërave janë një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e lojërave në internet. Me lidhjet internet të përmirësuara dhe të shpejta, më shumë lojtarë po shkarkojnë lojërat e tyre sesa po blejnë kopje fizike. Në Afrikën e Jugut, transaksionet në internet janë rritur me 13 përqind për lojtarët nga viti 2018 në 2019.³⁹

Megjithëse audiencat po diversifikohen, industria e lojërave ende mbizotërohet nga zhvilluesit meshkuj dhe shpesh kjo industri i shërben një audiencë mashkullore heteroseksuale të supozuar. Fatkeqësisht, kjo shpesh mund të çojë në krijimin e karaktereve femra të mbi-seksualizuara dhe një mungesë të veçantë të personazheve jo-meshkuj, jo të bardhë për të luajtur.

Krahas gamës së lojërave në celular, ka pasur gjithashtu një rritje të madhe të lojërave online. Jo të gjitha lojërat mund të luhen online, por të gjitha pajisjet e lojërave janë në gjendje të futen online tashmë. Të luash lojëra online gjithashtu do të thotë që përdoruesit mund të luajnë lojëra së bashku me të tjerët në internet. Disa lojëra lejojnë përdoruesit të luajnë vetëm me njerëz me të cilët janë "miq", por të tjera lojëra mund t'ju grupojë me lojtarë të tjerë nga e gjithë bota- herë rastësisht dhe ndonjëherë bazuar në nivelin e aftësive ose preferencave.

Ekzistojnë lloje të ndryshme lojërash në dispozicion dhe këto janë vazhdimisht në ndryshim. Disa nga lojërat dhe zhanret më të njohura janë renditur më poshtë:

First-person shooter (FPS) –Gjuajtësi i parë– lojëra aksioni të foksuara në armë ose luftëra të bazuara në hedhjen e predhave, nëpërmjet këndvështrimit të personit të parë p.sh. Call of Duty, Overwatch, BioShock, Battlefield

Aksion – aventurë – lojëra në të cilat lojtari përshkon dhe eksploron mjedise që shpesh përfshin luftim dhe zgjidhjen e puzzle p.sh. Grand Theft Auto (GTA), Super Mario, Uncharted, Legjenda e Zeldës, Zoti i Luftës.

Sporte – Lojëra që stimulojnë strategjinë dhe fizikun e sporteve profesionale në jetën reale p.sh.FIFA, Madden NFL, NBA.

³⁷ Isfe.eu (2019), *GameTrack In-Game Spending in 2019*, <https://www.isfe.eu/wp-content/uploads/2019/12/GameTrack-In-Game-Spending-2019.pdf>

³⁸ WEPC (2018), *2018 Video Game Industry Statistics, Trends & Data - The Ultimate List*, <https://www.wepc.com/news/video-game-statistics/>.

³⁹ Chris Cleverly (2019), *Mobile Gaming in Africa*, <https://medium.com/kamari-coin/mobile-gaming-in-africa-cc8bb6d7c49b>

Sandbox/Open World – Lojëra që përfshijnë minimalisht ose aspak tregime apo kufizime, të cilat lejojnë lojtarin të eksplorojë dhe ndryshojë botën virtuale sipas dëshirës p.sh. Minecraft, Terraria, Skyrim, Fallout.

Multiplayer Online Battle Arena (Moba) – lojëra në internet që luhen me dy ekipe konkurrense, të cilat përpiqen të kapin ose shkatërrojnë bazën e njëri-tjetrit p.sh. Dota 2, League of Legends, Heroes of Storm, Paragoni.

Ekzistojnë shqetësime në lidhje me varësinë që krijojnë lojërat në internet, e cila u përkufizua si çrregullim nga lojërat nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në 2018.⁴⁰ Kjo është përcaktuar në rishikimin e 11-të të Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve si *një model i sjelljes së lojërave ("lojra dixhitale" ose "Video-lojëra") karakterizuar nga kontrolli dëmtues i lojërave, përparësinë në rritje që i është dhënë lojërave mbi aktivitetet e tjera në atë masë që lojërat kanë përparësi mbi interesat e tjera dhe aktivitetet e përditshme, dhe vazhdimi ose përshkallëzimi i lojërave pavarësisht nga shfaqja e pasojave negative*. Është e rëndësishme të theksohet se në mënyrë që të evidentohet çrregullimi që vjen nga lojërat, modelet e sjelljes që janë shoqëruar me këtë çrregullim, të shihen për të paktën 12 muaj.

Një shqetësim tjetër kryesor që vjen nga lojërat është lidhja me lojërat e fatit në internet. Disa lojëra inkurajojnë përdoruesit për të provuar shansin në kutitë e parave, për shembull, kur një lojtar blen një kuti duke përdorur monedhën që përdoret në lojë (monedha në lojë blihet duke përdorur para të vërteta) në mënyrë që të përfitojë një shpërblim të përzgjedhur rastësisht (random).⁴¹

Kërkimet e fundit kanë zbuluar se tregu global i kutive të parave vlerësohet të jetë me vlerë 20 miliardë pound.⁴²

Inteligjenca Artificiale dhe Machine Learning

Inteligjenca artificiale gjeneron shumë interes nga media. Aplikimet e AI që janë ende duke u testuar po bëhen më të gjera. AI gjithashtu shkakton shqetësime dhe problematika në lidhje me paragjykimet që mund të ketë kundrejt saj.

Është e rëndësishme të përcaktohen domethënia e AI dhe machine learning edhe pse ende nuk ka një përkufizim universal dhe të gjithanshëm në dispozicion. Ky përkufizim varet nga qëllimi, fokusi dhe detyrat specifike. Kjo larmi përkufizimesh gjithashtu pasqyron përkufizimet diverse të "inteligjencës njerëzore". Ekziston gjithashtu një ndryshim midis detyrave specifike dhe atyre të përgjithshme: njerëzit janë të zotë në detyrat e përgjithshme, ndërsa për detyrat specifike, AI është vërtetë e avancuar.

Machine learning më së shpeshti u referohet metodave ku makineritë mund të mësojnë bazuar në të dhëna. Ajo synon të përgjithësojë të dhënat për të krijuar modele. Machine Learning përfaqëson 80 përqind të aplikacioneve aktuale të AI.

Ekziston një numër problematikash për t'u marrë në konsideratë, kur bëhet fjalë për IA:

⁴⁰ WHO (2018), *WHO | Gaming Disorder*, <https://www.who.int/features/qa/gaming-disorder/en/>.

⁴¹ Parentzone.org.uk (date?) , *What Are Loot Boxes?*, <https://parentzone.org.uk/article/what-are-loot-boxes>.

⁴² RSPH (2019), *Skins in the Game A High-Stakes Relationship between Gambling and Young People's Health and Wellbeing?* [https://www.rsph.org.uk/uploads/assets/uploaded/a9986026-c6d7-4a76-](https://www.rsph.org.uk/uploads/assets/uploaded/a9986026-c6d7-4a76-b300ba35676d88f9.pdf)

[b300ba35676d88f9.pdf](https://www.rsph.org.uk/uploads/assets/uploaded/a9986026-c6d7-4a76-b300ba35676d88f9.pdf)^{4a76b300ba35676d88f9.pdf}.

- Probleme të përcaktuara keq - përcaktimi i problemit është çelësi i suksesit.
- Disponueshmëria e të dhënave - shumë shpesh, të dhënat janë të gabuara, jo të përshtatshme, “të ndyra”, ose të pamjaftueshme. Të dhënat të përdorura për të trajnuar dhe zhvilluar AI dhe shërbimet algoritmike ka të ngjarë të fitohen nga përdorues të rritur. Kjo mund të nënkuptojë që sistemet e vendimmarrjes bazuar në algoritma dhe njohësit e modelit që përdorin AI mund të jenë shumë në qendër të të rriturve dhe për këtë arsye mund të rezultojnë në shërbime që keqkuptojnë /kategorizojnë gabim rreziqet/sjelljen e fëmijëve. Në mënyrë të ngjashme, setet e të dhënave dhe modelet e përdorura për të formësuar dhe informuar proceset vendimmarrëse të AI nuk mund të përfaqësojnë me saktësi ose marrin parasysh nevojat e disa njerëzve për shkak të përkatësisë etnike, gjinisë, aftësisë së kufizuar etj. Prandaj, fëmijët në këto grupe të nënpërfaqësuar mund të përjetojnë disavantazhe të shtuara që komplikohen ose shfrytëzohen më tej nga AI.
- Neglizhimi i të kuptuarit - ndonjëherë, gjërat funksionojnë mirë rastësisht ose një model është i mirë, por për diçka tjetër përveç problemit fillestar - për shembull, ka pasur histori në raportimin e mediave kur AI ka identifikuar gabim imazhet që kërkohen.
- Kostoja e gabimeve.

Inteligjenca artificiale është një zhvillim i mahnitshëm, por enigma që gjeneron është e ngjashme me atë të një makine që drejton vetë veten e saj.⁴³

6. Kuptimi i rreziqeve dhe dëmeve

Figura 7 tregon një klasifikim të rreziqeve online ndaj fëmijëve. Është pranuar se ka edhe rreziqe që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien (përdorimi i tepruar, privimi nga gjumi etj.).

Figura 7: Klasifikimi i rreziqeve online ndaj fëmijëve⁴⁴

	Përmbajtja	Kontakt	Sjellja
	Fëmija si marrës	Fëmija si pjesëmarrës (Fillues i aktivitetit për të rritur)	Fëmija si aktor (fajtor/viktim)

⁴³ Amy Maxmen (2018), *Self-Driving Car Dilemmas Reveal That Moral Choices Are Not Universal*, <https://www.nature.com/articles/d41586-018-07135-0>.

⁴⁴ Livingstone, S., Haddon, L., Görzig, A., and Ólafsson, K. (2011). *Risks and safety on the internet: The perspective of European children. Full findings*. LSE, London: EU Kids Online, <http://eprints.lse.ac.uk/33731/>

Agresiv	I dhunshëm/ përmbajtje e keqe	Ngacmim/ ndjekje	Bullizim, aktivitetre armiqësore me bashkëmoshatarët
Seksual	Përmbajtje pornografike	Pedofili, abuzim seksual në takimin me të huaj	Ngacmime seksuale, dërgim i fotografive seksuale me mesazhe
Vlera	Racist/ Përmbajtje me tone urryese	Bindje ideologjike	Përmbajtje e gjeneruar nga përdoruesi potencialisht e dëmshme
Komercial	Reklama, Marketing i përfshirë	Shfrytëzim dhe keqpërdorim të të dhënave personale	Bixhoz, të drejtat e autorit, shkelje

Figura 7 tregon një matricë që klasifikon rreziqet në internet për fëmijët. Kolonat kanë emërtimet: 1) Përmbajtja (fëmija si marrës (i prodhimeve masive)), 2) Kontakti (fëmija si pjesëmarrës (veprimtari e iniciuar nga të rriturit)), 3) Sjellja (fëmija si aktor (kryerësi / viktimë)). Katër rreshtat janë emërtuar: Agresive, Seksuale, Vlera, Tregtare/Komerciale. Për secilën rresht: Agresiv: 1 përmbajtje e dhunshme / e rëndë, 2 ngacmime, 3 bullizëm, veprimtari armiqësore. L Seksuale: 1 përmbajtje pornografike, 2 pastrim, abuzim seksual në takimin me të huaj, 3 ngacmime seksuale, sexting. Vlerat: 1 përmbajtje raciste / urrejtje, 2 bindje ideologjike, 3 përmbajtje potencialisht të dëmshme të krijuara nga përdoruesit. Komercial: reklama, marketing i ngulitur, 2 shfrytëzim dhe keqpërdorim i të dhënave personale, 3 lojëra të fatit, shkelje e të drejtës së autorit.

Burimi: EU Kids Online (Livingstone, Haddon, Görzig, and Ólafsson (2011))

Rast studimor nr. 1

Ky është një shembull i një djali që pa një video, e cila tregonte vrasjen e një piloti jordanez nga ISIS1. Djali dëgjoi historinë dhe çfarë kishte ndodhur në lajmet që po transmetoheshin në radio kur po kthehej në shtëpi me nënën e tij. Ai e pyeti në lidhje me këtë, por ajo nuk ishte e gatshme të fliste. Ajo fiku radion dhe ata u kthyen në shtëpi me heshtje. Djali ishte vërtet i shqetësuar për çfarë ai kishte dëgjuar - piloti ishte djegur i gjallë- dhe kur u kthye në shtëpi, ai bëri një kërkim në internet për të zbuluar më shumë dhe për të provuar dhe kuptuar se çfarë kishte ndodhur.

Një nga gjërat që iu ofrua atij nga kërkimi ishte një video që tregonte se çfarë kishte ndodhur -i postuar nga një kanal lajmesh. Djali u shpreh se e dinte se duhej të ndalonte së pari videon që në momentin që e filloi, por nuk mundi dhe ai shikoi të gjithë videon. kjo video e kishte trishtuar atë; ai po shihte makthe dhe kishte shqetësime nga e gjithë eksperiencia - megjithatë ai nuk i kishte thënë askujt sepse ishte i frikësuar nga reagimi i të tjerëve dhe me të vërtetë ndihej sikur do të fajësohej.

Ndoshta përgjigja nga nëna e tij është e kuptueshme dhe tregon se të rriturit do të përballen shpesh me disa nga përmbajtjet e papërshtatshme që mund të jenë të disponueshme në internet. S'ka rëndësis a sfiduese dhe e vështirë mund të jetë të bësh këto biseda, është e rëndësishme t'i zhvillojmë ato. Prindërit duhet të jenë të gatshëm të dëgjojnë fëmijët e tyre dhe të krijojnë një mjedis ku diskutimi mund të zhvillohet për çdo çështje që i shqetëson ata.

Përmbajtja

- Ekspozimi ndaj përmbajtjes së paligjshme dhe / ose potencialisht të dëmshme, të tilla si pornografia, lojërat e fatit, faqet e internetit të vetë-dëmtimit dhe përmbajtjeve të tjera të papërshtatshme për fëmijët dhe të rinjtë. Në shumicën e rasteve, operatorët e këtyre faqeve në internet nuk marrin masa efektive për të kufizuar hyrjen e fëmijëve dhe të rinjve.
- Ekspozimi ndaj kontaktit me përdorues të tjerë.
- Vetëdëmtimi, sjelljet shkatërruese dhe të dhunshme
- Ekspozimi ndaj radikalizimit dhe racizmit dhe fjalimeve dhe imazheve të tjera diskriminuese
- Mbështetja ose përdorimi i informacionit të pasaktë ose jo të plotë të gjetur në internet, ose informacion nga një burim i panjohur ose jo i besueshëm.
- Krijimi, marrja dhe shpërndarja e përmbajtjes së paligjshme dhe të dëmshme.

Manipulimi online

Fëmijët dhe të rinjtë janë gjithnjë e më të pranishëm në mjedisin online siç është ai i rrjeteve sociale ku janë të ekspozuar ndaj një larmie përmbajtjesh, të filtruar në bazë të algoritmave, me qëllim manipulimin e tyre në një mënyrë ose në një tjetër. Shembujt përfshijnë manipulimin politik (promovimi i pikëpamjeve të caktuara politike), lajme të rreme (përhapja e informacionit të rremë nëpërmjet politikës, tregtisë ose qëllimeve të tjera), reklamimi (krijimi i lidhjeve të hershëm të fëmijëve dhe të rinjve drejt markave ose produkteve specifike).

Këto mjedise të personalizuara nëpërmjet algoritmave mund të ndikojnë shumë tek zhvillimi i shëndetshëm, mendimet, preferencat, vlerat dhe zakonet tek fëmijët dhe të rinjtë, duke i

izoluar ata në "filluska filtri" dhe duke i ndaluar ata nga eksplorimi i lirë dhe hyrja në një larmi të gjerë mendimesh dhe përmbajtjesh.

Kontakt

- Pretendimi i të qenurit dikush tjetër, shpesh një fëmijë tjetër, si pjesë e një përpjekjeje të qëllimshme për dëmtim, ngacmim ose bullizim ndaj dikujt tjetër.

Online solicitation or grooming

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (Konventa Lanzarote) parashikon se grooming (solicitation of children for sexual parties) është një propozim i qëllimshëm, ku një i rritur takon një fëmijë i cili nuk ka arritur moshën ligjore për veprimtari seksuale, me qëllim kryerjen e akteve të abuzimit seksual ose të prodhimit të materialit për abuzim seksual të fëmijëve nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. (Solicitation) nuk rezulton domosdoshmërisht në një takim personal ballë për ballë. Mund të mbetet dhe thjesht një takim online dhe sidoqoftë të shkaktojë dëm serioz për fëmijën, për shembull përmes prodhimit, posedimit dhe transmetimit të materialeve të abuzimit seksual ndaj fëmijëve.⁴⁵ Në kontekstin e kërkesave dhe ngacmimeve seksuale ka shumë fokus në procesin e viktimizimit sepse hulumtimi ka përfshirë kryesisht vetë fëmijët dhe të rinjtë.

Rast studimor 2

Ky është shembulli i një vajze 13-vjeçare të cilës po i dërgoheshin fotografi të papërshtatshme nga një burrë i panjohur në Instagram. Burri po ndante me të fotografi ku shfaqej i zhveshur dhe gjithashtu i kërkoi vajzës që t'i dërgonte fotografi ku ekspozohej trupi i saj. Vajza nuk u bind, ajo e bllokoi profilin e këtij personi, e raportoi atë në Instagram dhe gjithashtu foli me disa nga miqtë e saj për të komfirmuar nëse e njejtja gjë u kishte ndodhur dhe atyre, dhe në të vërtetë ashtu ishte.

Edhe pse ajo bëri gjënë e duhur, vajza nuk i tha asgjë prindërve të saj nga frika e reagimit të tyre. Ajo ishte e bindur që ata do t'i thonin asaj se ajo nuk duhet të përdorte më Instagramin dhe kjo nuk ishte një opsion i përshtatshëm për të. Ajo shpjegoi se Instagram-i ishte vendi ku e gjithë shoqëria e saj ndanin lajme, thashetheme dhe bënin takimet e tyre shoqërore, diskutime se çfarë kishte ndodhur në shkollë atë ditë etj. Vajza vërtet besonte se prindërit e saj (me dëshirën për ta mbrojtur atë) do t'i thonin se ajo duhej të ndalonte së përdoruri platformën (Instagram).

Problemi është se vajza nuk kishte bërë asgjë të keqe-njeriu që dërgonte të tilla imazhe ishte ai që po silllej në mënyrë të papërshtatshme. Është një reagim i kuptueshëm i prindërve, të cilët dëshirojnë të mbrojnë fëmijët e tyre, por sigurisht që nuk është e drejtë të penalizohen fëmijët për diçka që dikush tjetër ka bërë. Ne duhet të supozojmë se shumica ose e gjithë ajo që po bënte kjo vajzë në Instagram ishte absolutisht korrekte. Është e rëndësishme që prindërit të mendojnë për reagimin e tyre kur fëmijët u tregojnë në lidhje me një problem që ata kanë hasur në internet. Ata gjithashtu duhet të dëgjojnë dhe t'u sigurojnë mbështetje fëmijëve të tyre

Bullizmi dhe ngacmimi

Bullizmi është njësoj kudo dhe sidoqoftë, ndodh. Bullizmi online mund të jetë veçanërisht shqetësues dhe dëmtues sepse tenton të përhapet më gjerësisht, me një shkallë më të lartë publiciteti. Për më tepër, përmbajtja e qarkulluar në mënyrë elektronike mund të rishfaqet

⁴⁵ Committee of the Parties to the Convention on the Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse (2015), *Opinion on Article 23 of the Lanzarote Convention and its explanatory note*, <http://rm.coe.int/coermpubliccommonsearchservices/displaydctmcontent?documentid=090000168064de98> .

në çdo kohë, gjë që e bën më të vështirë për viktimën e bulluar që të mbyllë incidentin; mund të përmbajë dëmtim të imazheve vizuale ose fjalë lënduese; përmbajtja është në dispozicion 24 orë në ditë. Bullizmi në mënyrë elektronike mund të ndodhë 24/7, kështu që mund të cënojë privatësinë e viktimës edhe në vende të konsideruara si "të sigurta" të tilla si në shtëpi, informacioni personal mund të manipulohet, imazhet vizuale të ndryshohen dhe të përcillen tek të tjerët. Më tej, mund të kryhet në mënyrë anonime.⁴⁶

Fëmijët dhe të rinjtë që janë viktimizuar në jetë reale ka të ngjarë të viktimizohen në internet. Sipas studimeve të fundit, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë abuzim të çfarëdo lloji, dhe posaçërisht ka më shumë të ngjarë të përjetojnë viktimizim seksual⁴⁷, duke qenë kështu në një rrezik më të lartë në internet. Viktimizimi mund të përfshijë bullizmin, ngacmimin, përjashtimin dhe diskriminimin bazuar në paaftësinë aktuale ose të perceptuar të një fëmije, ose aspekte që lidhen me paaftësitë e tyre të tilla si mënyra se si ata sillen ose flasin, ose pajisjet apo shërbimet që ata përdorin. Disa nga rreziqet mund të përfshijnë:

- Shpifje dhe dëmtim të reputacionit.
- Përdorim të paautorizuar të kartave të kreditit: kartat e kreditit të prindërve ose të tjerëve që mund të përdoren për të paguar tarifat e anëtarësimit, tarifa të tjera të shërbimit dhe mallrave.
- Përpyekjet kriminale për të hequr përdorues të internetit, kryesisht për përfitime financiare. Në disa raste, kjo mund të përfshijë vjedhje të identitetit, edhe pse kjo normalisht shoqërohet me përpyekje për të mashtruar të rriturit.
- Reklama të padëshiruara: Disa kompani gënjejnë fëmijët përmes faqeve të internetit për të shitur produkte. Kjo ngre si shqetësim çështjen e aprovimit të përdoruesve dhe si duhet të trajtohet kjo. Legjislacioni në këtë fushë nuk është i mjaftueshëm dhe është shumë e vështirë të përcaktohet momenti se kur fëmijët dhe të rinjtë janë në gjendje të kuptojnë transaksionet e të dhënave. Në të vërtetë, tashmë është shqetësim i madh mënyra se si do të zbatohen këto rregulla në Internet, dhe aksesit i telefonisë mobile e thekson edhe më shumë këtë problem.
- Kontakt i padëshirueshëm, veçanërisht me mashtrues të rritur që paraqiten si fëmijë dhe të rinj.

Sjellja

- Zbulimi i informacionit personal që çon në rrezik të dëmtimit fizik.
- Dëmtim fizik përmes takimeve në jetën reale me persona të njohur në internet, me mundësinë e abuzimit fizik dhe seksual.

⁴⁶ Dr Tanya Byron (2008), *The Report of the Byron Review: Safer Children in a Digital World*,
<https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20120107041050/>,
<https://www.education.gov.uk/publications/eorderingdownload/dcsf-00334-2008.pdf>.

⁴⁷ Mueller-Johnson, Eisner and Obsuth (2014), *Sexual Victimization of Youth With a Physical Disability: An Examination of Prevalence Rates, and Risk and Protective Factors*,
<http://journals.sagepub.com/doi/10.1177/0886260514534529>

- “Sexting“, ndarja e imazheve intime, që mund të rezultojnë në ngacmime seksuale, favore seksuale dhe abuzim bazuar në imazhe.⁴⁸

Sexting

Një sjellje e zakonshme nga adoleshentët është ‘sexting’ (ndarja e imazheve ose teksteve me natyrë seksuale përmes celularit). Këto imazhe dhe tekste shpesh ndahen midis partnerëve në një marrëdhënie ose me partnerë të mundshëm, por ndonjëherë përfundojnë duke u ndarë me audienca shumë më të gjera. Mendohet se nuk ka gjasa që adoleshentët të kuptojnë në mënyrë adekuate implikimet e këtyre sjelljeve dhe rreziqet e mundshme që ato sjellin.⁴⁹

Një shqetësim serioz me sexting është se fëmijët dhe të rinjtë mund të krijojnë materiale të paligjshme mbi abuzimin seksual, të cilat mund të çojnë në sanksione ligjore serioze. Disa nga rreziqet përfshijnë:

- Shënjestrimin përmes mendimeve dhe reklamave nga kompani spam që përdorin faqet e internetit për të promovuar produkte të targetuara në bazë të moshës dhe interesave.
- Sjellje që rezultojnë në rreziqe shëndetësore siç është ekspozimi në ekran: Përdorimi i detyrueshëm dhe i tepruar i internetit dhe / ose lojërave në internet, në dëm të aktiviteteve sociale dhe / ose të jashtme të rëndësishme për shëndetin, ndërtimin e besimit, zhvillimin shoqëror dhe mirëqenien e përgjithshme.
- Shkelja e të drejtave të tyre ose të tjerëve përmes plagjiaturës dhe ngarkimit të përmbajtjeve (veçanërisht fotografive) pa leje. Marrja dhe ngarkimi i fotove të papërshtatshme pa leje është vërtetuar të jetë i dëmshëm për të tjerët.
- Shkelja e të drejtës së autorit të personave të tjerë p.sh. duke shkarkuar muzikë, filma ose programe TV që duhet të paguhen.
- Përdorimi i postës elektronike të prindërve pa leje: Kërkohej leja e prindërve për të aktivizuar disa llogari në internet, por kjo mund të jetë e vështirë për ta që t’i fshijnë ato pasi i kanë aktivizuar. Fëmijët dhe të rinjtë e përdorin këtë metodë për të anashkaluar lejen.

Sondazhi i EU Kids Online 2020 tregon se si fëmijët dhe të rinjtë po i përdorin mediat e reja - në krahasim me mënyrën se si njerëzit mendojnë se po i përdorin ato.⁵⁰ Hulumtime të tjera

⁴⁸ Lanzarote Committee (2019), *Opinion on child sexually suggestive or explicit images and/or videos generated, shared and received by children*, <https://rm.coe.int/opinion-of-the-lanzarote-committee-on-child-sexually-suggestive-or-exp/168094e72c>

⁴⁹ UNICEF (2011), *Child Safety Online: Global Challenges and Strategies*, http://www.unicef.it/allegati/child_safety_online_1.pdf.

⁵⁰ Smahel, D., Machackova, H., Mascheroni, G., Dedkova, L., Staksrud, E., Ólafsson, K., Livingstone, S., and Hasebrink, U. (2020). *EU Kids Online 2020: Survey results from 19 countries*. EU Kids Online, <http://www.lse.ac.uk/media-and-communications/assets/documents/research/eu-kids-online/reports/EU-Kids-Online-2020-10Feb2020.pdf>

eksplorojnë sesi fëmijët mendojnë se të drejtat e tyre duhet të mbrohen në mjedisin dixhital⁵¹ si dhe funksionojnë në eksperiencat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.⁵²

Objektivi kryesor i një fushate mbi sigurinë në internet është të ndryshojë sjellje, përfshirë inkurajimin e sjelljes më të sigurt në internet për fëmijët dhe të rinjtë, inkurajimin e prindërimit efektiv në internet dhe inkurajimin e të tjerëve që ndërveprojnë me fëmijë dhe të rinj për t'i mësuar atyre si të qëndrojnë të sigurt në internet (anëtarë të tjerë të familjes, mësuesit, etj).

Siguria e fëmijëve dhe të rinjve në Internet nuk duhet të shihet si një çështje e izoluar, por përkundrazi si një çështje që ka të përbashkëta brenda një sërë iniciativash në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë, sigurinë e tyre dhe Internetin.

⁵¹ Council of Europe (2017), *It is Our World: Children's Views on How to Protect Their Rights in the Digital World*, <https://rm.coe.int/it-s-our-world-children-s-views-on-how-to-protect-their-rights-in-the-/1680765dff>.

⁵² Lundy et al. (2019), *TWO CLICKS FORWARD AND ONE CLICK BACK: Report on children with disabilities in the digital environment*, <https://rm.coe.int/two-clicks-forward-and-one-click-back-report-on-children-with-disabili/168098bd0f>.

7. Roli që luajnë prindërit dhe kujdestarët

Prindërit duhet të mbështesin fëmijët dhe të rinjtë në mënyrë që ata të mund të kenë përfitime nga teknologjia në mënyrë të sigurt. Ata duhet të kenë një qasje të ekuilibruar dhe të njohin gamën e gjerë të përfitimeve që mund tu sigurojë interneti. Prindërit mund të jenë të prirur të përqendrohen në përfitimet e shumta pozitive arsimore/të aftësive që mund të fitohen në internet, por është e rëndësishme që ata gjithashtu të marrin në konsideratë dhe të vlerësojnë benefitet sociale që fëmijët mund të përfitojnë- lojërat dhe eksplorimi i interesit personal mund të jenë motivuesit kryesorë që i bëjnë fëmijët të përdorin Internetin. Të kuptuarit e këtyre aspekteve mund t'i ndihmojnë prindërit të angazhohen dhe t'i mbështesin më mirë fëmijët. Në mënyrë që të sigurohen që fëmijët dhe të rinjtë të përdorin faqet e internetit në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi, prindërit dhe kujdestarët duhet të kenë kujdes sic vijon:

1. Familjarizimi me rreziqet dhe mundësitë që fëmijët dhe të rinjtë e tyre mund të hasin në internet. E rëndësishme është të jenë në gjendje të njihen kërcënimet e mundshme që mund të hasin fëmijët e tyre, dhe pse mendohet se rreziqet mund të mos sjellin dëm.
2. Të qëndruarit të angazhuar në mënyrë aktive në atë që fëmijët e tyre po bëjnë në internet, llojin e përmbajtjes që ata po shikojnë, ndajnë ose krijojnë, shërbimet, platformat dhe lojërat që po përdorin, si dhe njerëzit me të cilët po lidhen. Është gjithmonë e dobishme për prindërit që të provojnë shërbimet që fëmijët e tyre po përdorin.
3. Prindërit duhet të familjarizohen me uebfaqe dhe lojëra të posatshme për të mësuar dhe argëtuar që mund të përdorin me fëmijët e tyre. Një website ose lojë e mirë do të ketë një faqe të dedikuar sigurie me lidhje të qarta, mekanizma raportimi dhe udhëzime për fëmijët dhe të rinjtë dhe prindërit/kujdestarët e tyre.
4. Të pasurit një dialog të rregullt, të sqartë dhe të hapur me fëmijë dhe të rinj, që është i përshtatshëm për moshën dhe ndryshon me kalimin e kohës.
 - a. Sigurohuni që fëmijët dhe të rinjtë të kuptojnë rreziqet që mund të hasin dhe të bien dakord për veprimet që do të ndërmarrin nëse përballen me këto rreziqe - kjo mund të jetë thjesht biseda me ju.
 - b. Inkurajoni fëmijët dhe të rinjtë të mendojnë se si mund të jenë një qytetar i mirë dixhital, duke menduar për ato që ndajnë mbi veten dhe të tjerët, duke i ndihmuar ata të adoptojnë një mënyrë pozitive sjelljeje në internet.
 - c. Inkurajoni mendimin kritik për atë që shohin në internet, flisni se si jo të gjithë janë ata persona janë ata që thonë se janë, ose ato që shohin mund të mos jenë të vërteta. Flisni për manipulimin e imazhit vetjak dhe lajmet e rreme që synojnë të shfrytëzojnë njerëzit.
 - d. Flisni për presionin e moshatarëve dhe frikën e humbjes dhe menaxhimit të miqve në internet.
 - e. Flisni me ta për joshjen dhe varësinë ndaj teknologjisë, veçanërisht në shërbimet falas, ku koha që ata kalojnë në internet dhe të dhënat që ata ndajnë janë monedha ose modeli i biznesit.

5. Sigurohuni që fëmija të dijë kur dhe ku të marrë ndihmë. Në ndihmë mund tu vijë prindi ose kujdestari i tyre, një mësues ose një i rritur tjetër i besuar. Nxisni tek ta një qëndrim që, nëse përjetojnë ndonjë gjë shqetësuese në internet, ata duhet ta diskutojnë atë me një të rritur tek i cili besojnë.
6. Bini dakord për rregullat familjare për përdorimin e pajisjeve të lidhura, duke kuptuar që prindërit ose kujdestarët janë modele për sjelljen në internet.
7. Sigurohuni që fëmijët të kenë një dietë të ekuilibruar dixhitale, e tillë që koha e tyre në internet të kalojë mirë dhe të përmbajë një përzierje aktiviteteve që përfshin të mësuarit, krijimin dhe lidhjen në mënyra pozitive. Përdorni mjete të posaçshme për të parë modelet e përdorimit mbi kohën që është shpenzuar në aplikacione dhe shërbime.
8. Sigurohuni që ju dhe fëmijët tuaj jeni përdorues të aftë të mjeteve. Ka mjete të shumta që mund të ndihmojnë prindërit me ‘menaxhimin’ e teknologjisë së lidhur brenda dhe jashtë shtëpisë.
 - a. Merrni parasysh të gjitha pajisjet e lidhura, jo vetëm telefonat smart, tabletët dhe PC-të. Përfshini konsolat e lojërave, asistentët personalë, televizorët e lidhur dhe çdo pajisje tjetër që lidhet me Internet.
 - b. Përdorni vlerësimet e moshës për tju ndihmuar të vendosni se në cilat përmbajtje, lojëra, aplikacione dhe shërbime kanë akses fëmijët dhe të rinjtë. Jini të vetëdijshëm se vlerësimet e moshës mund të ndryshojnë në dyqanet e aplikacioneve dhe vetë platformat aktuale. Merrni parasysh përdorimin e cilësimeve për të kontrolluar se cilat aplikacione dhe lojëra mund të shkarkohen dhe përdoren.
 - c. Përdorni filtrimin e rrjetit, shpesh i referuar si kontroll prindëror, dhe motorrë të sigurt kërkimi ose kontrolle për të filtruar përmbajtjen që fëmijët dhe të rinjtë mund të aksesojnë në internet,
 - d. Si familje, kuptoni se si dhe kur duhet të raportoni ndonjë përmbajtje për të cilën ata nuk janë të lumtur, të shqetësuar ose që ndihen se i prish termat dhe kushtet e privatësisë. Mësoni si të bllokoni kontaktet e padëshiruara ose të pakërkuara.
 - e. Mendoni me shumë kujdes mbi përdorimin e aplikacioneve dhe teknologjive të monitorimit që ndjekin përdorimin e internetit të një fëmije. Ato mund të kenë pasoja të padëshiruara në zhvillimin e sjelljeve sekrete në internet dhe gjithashtu mund të shkaktojnë dëm në situata të dhunës në familje. Nëse i përdorni, shpjegojini fëmijës tuaj se çfarë jeni duke monitoruar dhe pse.
 - f. Më e rëndësishmja, teksa fëmijët dhe të rinjtë rriten dhe maturohen, rivlerësoni përdorimin e kontrolleve dhe kufizimeve për t'u siguruar që ato janë të përshtatshme për moshën; është e rëndësishme të nxisni qëndrueshmëri tek fëmija juaj që ky i fundit të jetë në gjendje të përfitojë sa më shumë në internet.
9. Mësoni fëmijët tuaj të mos ndajnë fjalëkalimet e tyre me miqtë, vëllezërit apo motrat. Mendoni se kur dhe ku ata po ndajnë informacionin personal, për shembull një profil që mund të shihet globalisht mund të dëshirojë të përdorë një foto të një profili

jopersonal dhe të minimizojë informacionin personal rreth moshës, shkollës dhe vendndodhjes.

10. Mos mendoni se të gjithë personat në Internet po targetojnë fëmijën tuaj. Në përgjithësi, faqet e internetit të fëmijëve mund të jenë të sigurta dhe mund të sigurojnë një përvojë të mrekullueshme, krijuese, sociale dhe edukative për fëmijën tuaj, por mos harroni të qëndroni të përfshirë dhe të kujdesshëm.
11. Qëndroni të qetë dhe mos nxirrni përfundime nëse dëgjoni ose shihni ndonjë gjë që ju shqetëson në lidhje me sjelljen e fëmijës tuaj ose sjelljen e një prej miqve të tyre në internet. Shmangni kërcënimin për heqjen ose konfiskimin e pajisjeve pasi ato mund të jenë shumë të rëndësishme për disa të rinj. Nëse fëmija juaj ka frikë se do t'ia hiqni këto pajisje, ka të ngjarë që ata gjithnjë e më shumë të hezitojnë të ndajnë problemet ose shqetësimet që mund të kenë.
12. Rimëkëmbja dhe të mësuarit nga përvojat janë elemente jetike të zhvillimit të rezistencës dixhitale. Nëse fëmijët përjetojnë rrezik ose dëmtim online, prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të gjejnë mënyra për t'u rikuperuar në mënyrë që ata të jenë në gjendje të përfitojnë në mënyrë të sigurt nga aspektet pozitive kur është e përshtatshme dhe të shmangin përjashtimin kur është e mundur.

Ku të kërkojmë ndihmë?

Shumë vende ofrojnë ndihmë për fëmijët dhe të rinjtë, ku ata mund të raportojnë problemet e tyre. Këto vende janë publikuar gjerësisht dhe vende të ndryshme kanë qasje të ndryshme për transmetimin e këtij mesazhi. Është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë të kuptojnë se nuk është kurrë vonë për të raportuar një problem dhe se duke vepruar në këtë mënyrë, ata mund të ndihmojnë të tjerët.

Ndërsa fëmijët dhe të rinjtë e pranojnë se ndonjëherë ia lejojnë vetes të bien pre e sjelljeve të rrezikshme, ato nuk duken shumë të shqetësuar për rreziqet e qenësishme të kësaj sjellje dhe paraqesin një preferencë për të zgjidhur problemet vetë ose brenda grupit të tyre. Kjo nënkupton që ata t'u drejtohen prindërve të tyre ose të rriturve të tjerë vetëm në raste ku problemet bëhen potencialisht “dramatike”. Ky është një problem veçanërisht me djemtë në moshë të rritur, të cilët kanë më shumë të ngjarë të përdorin butonin “Report Abuse”⁵³ (i zhvilluar nga Virtual Global Task Force), në vend që të kërkojnë ndihmë te prindërit ose tek të rriturit e tjerë. Sidoqoftë, kjo nuk është situatë e njejtë për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Ne shohim se fëmijët dhe të rinjtë të cilët janë të vetëdijshëm për rreziqet, mbrojnë privatësinë e aktivitetit të tyre, por shpesh nuk ndajnë pamje të teknologjive të reja, që nënkupton që të rriturit duhet të jenë pika kryesore për gjykimin dhe monitorimin e sjelljes së fëmijëve dhe të rinjve.⁵⁴ Është e nevojshme të jemi të kujdesshëm për ta patur të qartë dallimin midis botës reale dhe botës virtuale, pasi kjo, nuk përfshin më mënyrën se si e përditshmja jonë është lidhur, gjithnjë e më shumë me teknologjitë online. Për shumë fëmijë dhe të rinj, kjo do të thotë negociim i kujdesshëm midis mundësive që teknologjia ofron (të tilla si eksplorimi i identitetit të tyre, krijimi i marrëdhënieve të ngushta dhe rritja e shoqërisë) dhe rreziqeve (në

⁵³ Europol (2019), *2019 Virtual Global Taskforce Releases Environmental Scan*,

<https://www.europol.europa.eu/newsroom/news/2019-virtual-global-taskforce-releases-environmental-scan> .

⁵⁴ Manida Naebklang (2019), *Report of the World Congress III against Sexual Exploitation of Children & Adolescents*, https://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/ECPATWCIIIReport_FINAL.pdf.

lidhje me privatësinë, keqkuptimet dhe praktikat abuzive) të ardhura nga komunikimi i mundësuar nga interneti.⁵⁵

Prindërit dhe edukatorët duhet të jenë të vetëdijshëm se nëse ata dyshojnë në abuzim seksual online, atëherë shkelësi duhet të bllokohet dhe komunikimi të ruhet si provë. Prindërit nuk duhet kurrë të shohin imazhet seksuale të krijuara nga fëmija e tyre ose fëmijë të tjerë. Këto materiale duhet të dorëzohen para ligjit dhe duhet të raportohet abuzimi ose shfrytëzimi i fëmijës në autoritetin përkatës. Prindërit nuk duhet ta fotografojnë kurrë veten si fëmija e tyre në mënyrë që të "provojnë" abuzimin.

Informacione të mëtejshme mund të gjenden në lidhje me mënyrën sesi të raportojmë imazhe seksuale të fëmijëve këtu:

Internet Watch Foundation – <https://www.iwf.org.uk/>

NCMEC – <https://report.cybertip.org/>

Europol – <https://www.europol.europa.eu/report-a-crime/law-enforcement-reporting-channels>
<https://www.europol.europa.eu/report-a-crime/law-enforcement-reporting-channels-child-sexual-coercion-and-extortion>

⁵⁵ Livingstone (2008), *Taking Risky Opportunities in Youthful Content Creation: Teenagers' Use of Social Networking Sites for Intimacy, Privacy and Self-Expression*, <http://journals.sagepub.com/doi/10.1177/1461444808089415> (last visited 16 January 2020).

8. Udhëzues për prindërit, kujdestarët dhe rojet

Këshillat e sigurisë bazohen në analizën e të dhënave të mbledhura dhe hulumtimet në dispozicion. Ky seksion ka për qëllim të sigurojë udhëzime për prindërit, kujdestarët dhe rojet (dhe edukatorët në një listë të vecuar) për t'i ndihmuar ata të mësojnë fëmijët dhe të rinjtë se si të kenë një përvojë pozitive, të sigurt dhe të vlefshme në internet.

Prindërit, kujdestarët dhe rojet duhet të kenë parasysh natyrën e saktë të faqeve online, dhe se sa fëmijët e tyre kuptojnë mbi rreziqet dhe gjasat që prindi mund të zvogëlojë rreziqet, para se të vendosin se cili mjedis është i përshtatshëm për fëmijën e tyre.

Interneti ka një potencial të madh si një mjet që fuqizon fëmijët dhe të rinjtë për t'i ndihmuar dhe për t'i zbuluar gjërat vetë. Të mësuarit të formave pozitive dhe të përgjegjshme të sjelljes online janë objektiv kyc. Tabela 1 ndan çështjet në fusha kryesore për t'u marrë në konsideratë nga prindërit dhe kujdestarët.

Table 1: Fushat kryesore për t'u konsideruar për prindërit, kujdestarët dhe rojet

Prindër, Roje			
	#	Key Areas for consideration	Description

Siguria dhe privatësia e teknologjive tuaja	1.	Diskutoni me fëmijën tuaj. Bëni aktivitete online me ta	<p>Interesohuni për atë që fëmijët po bëjnë në internet, bisedoni me ta. Është i rëndësishëm fakti që fëmijët dhe të rinjtë nuk ndiejnë se prindërit nuk u besojnë atyre. Filtrimi, monitorimi dhe kufizimi i aksesit është i rëndësishëm por duhet të ndodhin së bashku me dialogun dhe diskutimin. Kur fëmijët dhe të rinjtë kalojnë kohë me të tjerët jashtë shtëpisë, ata mund të bien në kontakt me pajisje të tjera (ndoshta të pakufizuar), prandaj, lind nevoja për komunikim të mirë- a do t'ju tregojnë ata nëse diçka nuk shkon sic duhet? Është e rëndësishme të mos reagoni më tepër seç duhet nëse fëmijët dhe të rinjtë ju tregojnë për diçka që i ka ndodhur online. E rëndësishme është që ata ju tregojnë problemin e tyre dhe duke reaguar në mënyrën e duhur ka më shumë gjasa që ata të ndihen të sigurt nga ndihma juaj, dhe përsëri të vijnë për ndihmë tek ju në një moment tjetër.</p> <p>Të kuptuarit se çfarë është interneti mund të jetë e dobishme për fëmijët dhe të rinjtë, që në mënyrë ata të kenë kujdes më të madh në "hapësirën" e internetit, aty ku ekzistojnë platformat e tyre të preferuara si Instagram, Snapchat ose YouTube.</p> <p>Interneti shpesh mund të duket si një vend abstrakt për fëmijët dhe të rinjtë dhe pa e kuptuar atë, ata mund ta kenë më të vështirë që të kuptojnë rreziqet dhe t'i njohin/vizualizojnë ato. Një analogji e mundshme, mund të ishte ajo e një qyteti të madh i cili ka shumë vende të këndshme dhe njerëz të bukur</p>
---	----	---	---

			<p>por edhe zona që nuk do t'i vizitonit pasi ato mund të jenë të rrezikshme. Kjo do të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të reflektojnë në "audienca" të ndryshme që mund të hasin gjatë lundrimit të tyre në internet dhe si mund të rrjedhë informacioni etj. Prindërit duhet të interesohen për atë që bëjnë fëmijët e tyre online dhe të jenë të përgatitur për të ndarë përvoja dixhitale me ta si një mënyrë për të forcuar besimin dhe për të inkurajuar dialog mes tyre.</p>
--	--	--	--

Prindër, kujdestarë			
	#	Fushat kryesore për t'u konsideruar	Përshkrimi

	2.	<p>Identifikoni teknologjinë, pajisjet dhe shërbimet në të gjithë shtëpinë/ familjen tuaj.</p>	<p>Duke filluar me pajisjet, identifikoni të gjitha pajisjet në shtëpinë tuaj që janë të lidhura, përfshirë edhe celularët, laptopë, tableta si dhe televizora smart, konsola lojrash, gjurmues të fitnesit, të përdorura nga e gjithë familja. Identifikoni shërbimet dhe aplikacionet online që po përdoren nga e gjithë familja në këto pajisje.</p>
	3.	<p>Instaloni firewall dhe softuer antivirus në të gjitha pajisjet. Merrni në konsideratë se qoftë programet filtruese ose bllokuese apo ato monitoruese, mund t'ju japin suport dhe janë të përshtatshme për familjen tuaj.</p>	<p>Sigurohuni që pajisjet tuaja të kenë antivirus dhe mbrojtje të instaluar ndaj malware-ve dhe që të mbahen të përditësuara. Mësojuni fëmijëve tuaj bazat e sigurisë në Internet.P.sh. a është sistemi juaj operativ i përditësuar, a jeni duke përdorur versionin më të fundit të një aplikacioni? A janë të përditësuara termat e sigurisë? Produktet e filtrimit dhe monitorimit janë të dobishëm- por çështjet e sigurisë dhe privatësisë duhet të konsiderohen gjithashtu. Prindërit duhet të bisedojnë me fëmijët e tyre se pse po përdorin të tilla programe në mënyrë që familja të jetë e sigurt.</p>

Rregulla	4.	<p>Bini dakord familjarisht për pritshmëritë në lidhje me përdorimin e internetit dhe pajisjeve personale, duke dhënë vëmendje të vecantë çështjeve të privatësisë, faqeve të papërshtatshme të internetit, aplikacioneve dhe lojërave, bullizmit dhe rrezikut nga të huajt. Sigurohuni gjithashtu që ekziston një kulturë suporti nështëpi në mënyrë që fëmijët dhe të rinjtë të kenë mundësi për të kërkuar mbështetje nga prindërit/ kujdestarët.</p>	<p>Sapo fëmijët dhe të rinjtë fillojnë të përdorin teknologjinë, diskutoni dhe krijoni një listë me rregullat për të cilat keni rënë dakord. Këto rregulla duhet të përfshijnë momentin se kur fëmijët dhe të rinjtë mund të përdorin internetin dhe mënyrën se si ata duhet ta përdorin atë, si dhe kohën e caktuar për të ndenjur para ekranit.</p> <p>Roli dixhital i modeit- është e rëndësishme që prindërit të vendosin shembullin e duhur për fëmijët e tyre. Ata kanë të ngjarë të adoptojnë sjelljet e duhura nëse janë duke u udhëzuar nga prindërit/ kujdestarët. Kjo mund të shtrihet në marrjen dhe ndarjen e fotografive- konsensusi duhet të arrihet para se të postohet ndonjë imazh në internet. Konsiderimi i përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale nga vet prindërit në lidhje me fëmijën e tyre, të tilla si ndarja e historive personale ose foto të fëmijës. Respektojeni privatësinë e fëmijës si tani ashtu edhe në të ardhmen. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të jenë në gjendje të vijnë dhe të flasin për çdo presion dhe sfidë online (dhe offline) me të cilat përballen. Një mënyrë për të zhvilluar diskutim është përdorimi i historive të shfaqura në media mbi sjelljet në internet. Kjo do ta përgjithësonte çështjen, por do t'u japë njëkohësisht fëmijëve dhe të rinjve lirinë për të shprehur mendimin e tyre.</p>
----------	----	--	--

Edukimi i prindërve dhe kujdestarëve	5.	Jini të kujdesshëm për shërbimet mobile dhe online të përdorura nga fëmijët tuaj (d.m.th. mediat sociale, faqet e internetit, aplikacionet, lojërat etj.) dhe jini në dijeni se si fëmijët e kalojnë kohën e tyre online.	Kuptoni se si të siguroheni që fëmijët dhe të rinjtë po përdorin aplikacione dhe platforma sa më të sigurta të jetë e mundur, duke përfshirë bërjen e llogarive private, të qënurit të vetëdijshëm për kufizimet e moshës etj. Përdorni mjetet që vijnë me pajisjet mobile siç janë Family Link ose mjete të tjera të kontrollit prindëror. Kontrolloni nëse ndonjë produkt është shitur apo janë bërë blerje brenda aplikacionit. Mundohuni të kuptoni motivimet e fëmijëve dhe të rinjve kur ata janë në internet. Pse po përdorin uebfaqe dhe shërbime të veçanta? Çfarë nënkuptojnë faqet e internetit dhe shërbimet e ndryshme për sa i përket grupeve të miqësisë, ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë? Kjo gjë gjithashtu do t'ju ndihmojë të kuptoni më mirë sfidat shoqërore dhe emocionale me të cilat mund të përballen fëmijët dhe të rinjtë (të cilat nganjëherë mund të rezultojnë në sjellje të rrezikshme) dhe jepini atyre njohuri se si të ndërtojnë qëndrueshmëri.
--------------------------------------	----	---	---

Rishikimi i karakteristikave të faqeve të Internetit	6.	Konsideroni moshën dixhitale të pranuar	Disa vende kanë ligje që specifikojnë një minimum moshe, të cilën një kompani ose faqe në internet mund t'ja kërkojë një të riu, në mënyrë që të ketë mundësi të ofrojë informacion personal për veten e tij pa marrë më parë konfirmimin e verifikueshëm të prindërve. Kjo moshë e digital consent "pranimit dixhital" zakonisht varion midis 13 dhe 16vjeç. Në disa vende mendohet të jetë praktikë e mirë aprovimi i prindërve para se një fëmijë apo i ri të pyetet për të dhënat e tij personale ndërsa në vende të tjera, është e vendosur me ligj (shih artikullin 8 GDPR për Shtetet Anëtare të BE-së). Shumë faqe në internet të cilat kujdesen për fëmijë të vegjël kërkojnë pëlqimin e prindërve përpara se të lejohet një përdorues i ri t'i bashkohet rrjetit. Kontrolloni cdo shërbim për kërkesat minimale të moshës.
	7.	Kontrolloni përdorimin e kartave të kreditit dhe mekanizmave të tjera paguese	Shumë pajisje, aplikacione dhe shërbime mund të përdoren për të bërë blerje dhe menaxhim të kujdesshëm të llogarive prindërore me mekanizma paguese të ruajtura dhe karta krediti. Është e rëndësishme të mbahen të sigurta kartat e krediti dhe debitit, dhe tmos shfaqet pin-i për të shmangur aksesin e paautorizuar.

	8.	Raportimi	Duhet të dihen mënyra se si të raportohen probleme në platformat që po përdorin fëmijët tuaj dhe si të fshihen apo të bëhen ndryshime në profile- me rritjen e fëmijëve, sigurohuni që ata të dijnë t'i bëjnë këto. Gjithashtu, jini të vetëdijshëm mbi raportimet lokale.
	9.	Reklamimi, disinformimi dhe mosinformimi	Jini të vetëdijshëm se reklamat mund të jenë të papërshtatshme ose çorientuese. Flisni me fëmijët tuaj se si ata mund të raportojnë reklama dhe se si të kenë më shumë kontroll në çfarë ata shohin në internet. Është e rëndësishme të pranojmë se ajo çfarë mund të shohin fëmijët dhe të rinjtë në internet ndikon në pikëpamjet e tyre. Angazhohuni me ta për t'i ndihmuar të zhvillojnë ndergjegjësimin mediatik në internet.

Edukimi i 10. Krijoni një kulturë fëmijëve suporti

11. Ndërsa fëmijët dhe të rinjtë mësojnë më shumë për botën online, ata mund të shfaqin dëshirën për t'u takuar me njerëz që nuk i njohin në jetën reale, por me ata që kanë krijuar lidhje në internet. Është e rëndësishme që ju të ndërmerrni hapat e duhur për t'i edukuar ata mbi rreziqet e takimit me njerëz të huaj, me të cilët kanë komunikuar në internet.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të kuptojnë që bota online është një reflektim i botës offline - me përvoja të mira dhe të këqija. Është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë të ndihen të sigurt se mund të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nëse diçka nuk ka shkuar sic duhet dhe të jenë vetë në gjendje të ofrojnë dhe ata gjithashtu mbështetje për të tjerët online. Në varësi të moshës së fëmijëve tuaj, është e nevojshme të kuptoni përmbajtjen që ata kanë postuar dhe çdo profil në internet. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të jenë në gjendje të njohin rreziqet në internet - disa janë të dukshme, por disa më pak të dukshme – si psh. detyrimi, shantazhi, turpërimi. Të gjithë këta mekanizma përdoren nga abuzuesit dhe kriminelët. Fëmijët dhe të rinjtë gjithashtu duhet të kuptojnë që aksesit në internet vjen me përgjegjësi.

Ata duhet të dinë që ligjet zbatohen si online ashtu dhe offline, dhe se ata duhet të sillen në mënyrën e duhur.

Fëmijët dhe të rinjtë mund të jenë në një rrezik real nëse takohen personalisht me njerëz të panjohur me të cilët kanë komunikuar vetëm në internet. Njerëzit në internet mund të mos jenë ata që thonë se janë. Sidoqoftë, nëse krjohet një miqësi e fortë dhe e vërtetë në internet dhe fëmija juaj dëshiron të dalë në një takim, në vend që të rrezikoni që ata të shkojnë vetëm ose të pashoqëruar, bëjuani të qartë se preferoni të shkoni me ta, ose sigurohuni që një person tjetër i rritur i besuar të shkojë.

Është e qartë se kjo do të varet nga moshja e fëmijës. Është gjithashtu e rëndësishme të jeni të vetëdijshëm se ka pasur një rritje të sulmeve pa kontakt nga kriminelë dhe autorë të cilët, nuk duan të takojnë fëmijën por të marrin përmbajtje të qarta seksuale prej tyre.

12.	Rëndësia e informacionit personal.	Ndihmoni fëmijët tuaj të kuptojnë dhe menaxhojnë informacionin e tyre personal. Shpjegojuni se fëmijët dhe të rinjtë duhet të postojnë vetëm informacione që ju -dhe ata – të jeni komod që të tjerët mund t'i shohin. Ata nuk duhet të ndajnë informacione personale të identifikueshme. Kujtoju fëmijëve dhe të rinjve se ata kanë një reputacion në internet, i cili duhet të menaxhohet. Në momentin që një përmbajtje e caktuar është shpërndarë, mund të jetë e vështirë të ndryshohet/përshtatet.

Edukimi i fëmijëve	13. Siguroni që fëmijët dhe të rinjtë të kuptojnë çfarë do të thotë të postosh fotografi në internet, përfshirë fotografi të vetes apo miqve të tyre.	Shpjegojuni fëmijëve tuaj se fotografitë mund të zbulojnë shumë informacione personale. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të kuptojnë rreziqet e përdorimit të kamerave dhe ngarkimit të përmbajtjeve të ndryshme. Imazhet e të tjerëve nuk duhet të ngarkohen/publikohen pa pëlqimin e tyre. Kjo duhet të përfshijë gjithashtu ngarkimin e imazheve të fëmijëve nga vetë prindërit e tyre. Prandaj, është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë të kuptojnë se ndonjëherë mund të jenë të tjerët, në familje ose në rrethin e tyre shoqëror, të cilët mund të nxjerrin informacione, kështu që ata duhet të flasin me miqtë dhe familjen, si dhe t'i edukojnë ata rreth shpërndarjes së tepruar të informacionit. Inkurajoni fëmijët tuaj të mos postojnë fotografi të tyre ose të miqve të tyre me detaje të identifikueshme siç janë shenjat në rrugë, targa të makinave, ose emrin e shkollës së tyre, të stampuar në veshje.
--------------------	---	--

9. Roli i kujdestarëve

Është shumë e rëndësishme që kujdestarët të mos bëjnë ndonjë supozim për atë që fëmijët dhe të rinjtë mund ose nuk mund të dinë për çështjen e sigurisë në internet. Për shembull, një rol i rëndësishëm për kujdestarët është që duhet të mësojnë fëmijët dhe të rinjtë në lidhje me rëndësinë e fjalëkalimeve, si t'i mbajnë të sigurt dhe si të krijojnë një fjalëkalim të fortë. Shumë adoleshentë ndajnë fjalëkalime me njëri-tjetrin, dhe kjo shpesh shihet si një shenjë e miqësisë së vërtetë.

Ekziston një debat për privatësinë e fëmijëve dhe të rinjve në internet dhe një studim i kryer nga “London School of Economics” zbuloi se fëmijët dhe të rinjtë e vlerësojnë privatësinë e tyre dhe përfshihen në strategji mbrojtëse, por ata gjithashtu vlerësojnë aftësinë për të qenë në gjendje të angazhohen në internet. Në mënyrë të ngjashme, studimi zbuloi se ndërmjetësimi prindëror ishte i rëndësishëm në fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve, pasi i lejon ata të përjetojnë disa rreziqe gjatë mësimin sesi të mbrohen në momentin që punojnë të pavarur. Ai gjithashtu vuri në dukje se *“burimet e shkruara në media dhe trajnimet për prindërit, arsimtarët dhe punëtorët për mbështetjen e fëmijëve duhet të merren parasysh, sepse aktualiteti tregon se ka boshllëqe të konsiderueshme në njohuritë e të rriturve për rreziqet dhe strategjitë mbrojtëse në lidhje me të dhënat dhe privatësinë e fëmijëve dhe të rinjve në internet”*.⁵⁶

⁵⁶ Sonia Livingstone, Mariya Stoilova, and Rishita Nandagiri (2018), Children’s Data and Privacy Online: Growing up in a Digital Age, <http://www.lse.ac.uk/media-and-communications/assets/documents/research/projects/childrens-privacy-online/Evidence-review-final.pdf>

Shkollat kanë mundësinë të transformojnë arsimin dhe të ndihmojnë nxënësit të përmbushin potencialin e tyre dhe të rrisin standardet në TIK. Sidoqoftë, është e rëndësishme që fëmijët dhe të rinjtë të mësojnë se si të jenë të sigurt kur përdorin këto teknologji të reja, veçanërisht duhet të jenë më bashkëpunues në teknologji të tilla si platformat dhe shërbimet e rrjeteve sociale, të cilat janë një aspekt thelbësor i shoqërisë produktive dhe krijuese. Fëmijët dhe të rinjtë tani janë të aftë të krijojnë përmbajtjen e tyre dhe e ndajnë këtë gjerësisht përmes platformave të mediave sociale, shumica e të cilave lejojnë gjithashtu transmetimin e drejtpërdrejtë (live).

Kujdestarët mund të ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë të përdorin teknologjinë me mençuri dhe siguri:

- Të sigurohen që shkolla ka një sërë politikash dhe praktikash të forta dhe efektiviteti i tyre të rishikohet dhe vlerësohet rregullisht.
- Të kontribuojnë në zhvillimin e aftësive dixhitale dhe shkrim-leximit dixhital duke përfshirë edukimin e qytetarisë dixhitale në kurrikulën e tyre. Është e rëndësishme të përfshihen konceptet shoqërore dhe emocionale pasi këto do të mbështesin studentët të kuptojnë dhe menaxhojnë emocione për të pasur marrëdhënie të shëndetshme dhe të respektueshme, si online ashtu edhe jashtë ambientit virtual.
- Të sigurohen që të gjithë janë të vetëdijshëm për politikën e (AUP) dhe përdorimin e saj. Është e rëndësishme të keni një AUP, e cila duhet të jetë e përshtatshme për moshën.
- Të kontrollohen nëse politika shkollë kundër bullizmit përfshin referenca ndaj ngacmimit në Internet dhe përmes telefonave celularë ose pajisjeve të tjera dhe se ka sanksione efektive në vend për shkeljen e kësaj politike.
- Të emërohet një koordinator i sigurisë në internet.
- Të sigurohet që rrjeti shkollor është i sigurt.
- Të sigurohet një ofrues i akredituar i shërbimit të Internetit.
- Të përdoret një produkt filtrimi / monitorimi.
- Të bëhet shpërndarja e një broshure të edukimit mbi sigurinë në internet për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë dhe specifikimi se ku, si dhe kur do të dorëzohet.
- Të sigurohet që i gjithë stafi (përfshirë stafin ndihmës) janë trajnuar në mënyrë adekuate dhe se trajnimi i tyre bëhet rregullisht.
- Të jetë një pikë e vetme kontakti në shkollë, e cila të jetë në gjendje të mbledh dhe të regjistrojë incidente të sigurisë në internet të cilat do t'i japin shkollës një pasqyrë më të mirë të çështjeve ose trendeve të cilat duhet të adresohen.
- Të sigurohet që ekipi drejtues dhe senatorët e shkollës kanë një ndërgjegjësim adekuat të sigurisë në internet në shkollë.
- Të ketë një kontroll sistematik të të gjitha masave të sigurisë në internet.
- Të vlerësohet efekti arsimor dhe psikologjik që ka interneti dhe Teknologjitë e Informacionit tek fëmijët dhe të rinjtë.
- Përdorimi i internetit nga fëmijët dhe të rinjtë është rritur në mënyrë dramatike vitet e fundit dhe është shoqëruar nga një rritje e shqetësimit rreth çështjeve të sigurisë

në internet. Historikisht, ka pasur një panik moral për rrezikun e mundshëm tek teknologjitë e komunikimit dhe kjo ka qenë veçanërisht për femrat. Sidoqoftë, është vërtetuar që shpesh nuk është teknologjia fajtoare por më shumë rritja e aktivitetit të fëmijëve dhe të rinjve që përdorin teknologjinë, dhe humbja e kontrollit prindëror. Mësuesit janë perceptuar të kenë një rol jetësor në promovimin dhe garantimin e sigurisë në internet. Prindërit në të gjithë botën duket se besojnë se shkollat duhet të ketë një rol qëndror në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në përdorimin e sigurt të teknologjisë, por është gjithashtu e qartë nga studimet se burimi kryesor i informacionit online për fëmijët dhe të rinjtë janë nga shkolla dhe nga prindërit.⁵⁷ Udhëzime të mëtejshme mbi kompetencat që duhet të përfshihen në këtë lloj arsimi u identifikuan si pjesë e projektit të Këshillit të Evropës për edukimin e qytetarisë dixhitale.⁵⁸

Figura 8: Deklarata e fëmijëve se nga u është dhënë informacion ose këshillë rreth mënyrës së përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt, midis atyre që aksesojnë internetin në shtëpi (2012) dhe jashtë (2017,2018,2019) bazuar në moshë⁵⁹




Figure 8 Fëmijët duke deklaruar se u është dhënë informacion ose këshilla se si të përdorin internetin në mënyrë të sigurt, midis atyre që aksesojnë internetin në shtëpi (2012) ose diku tjetër (2017, 2018, 2019), sipas moshës (8 deri 11 dhe 12 deri në 15) tregon seri vitesh në grafikët sipas moshës duke treguar nëse ndonjë informacioni ishte marrë ose jo, dhe duke dhënë shtatë burime: nga mësuesi, prindi, nga miqtë, nga një anëtar tjetër i familjes, nga policia që vjen në shkollë, nga faqet e internetit, nga TV / radio programeve. Për shumë prej burimeve, ka një rritje të qëndrueshme të numrave për 2012, 2017, 2018 dhe 2019.

⁵⁷ Ofcom (2020), Children and Parents: Media Use and Attitudes Report 2019, https://www.ofcom.org.uk/_data/assets/pdf_file/0024/190518/children-media-use-attitudes-2019-chart-pack.pdf

⁵⁸ Council of Europe (2018), *Guidelines to Respect, Protect and Fulfil the Rights of the Child in the Digital Environment, Recommendation CM/Rec(2018)7 of the Committee of Ministers, Building a Europe for and with Children*, <https://rm.coe.int/guidelines-to-respect-protect-and-fulfil-the-rights-of-the-child-in-th/16808d881a>.

⁵⁹ Ofcom (2020), *Children and Parents: Media Use and Attitudes Report 2019*, https://www.ofcom.org.uk/_data/assets/pdf_file/0024/190518/children-media-use-attitudes-2019-chart-pack.pdf

- Qasjet e hershme për sigurinë në internet u përqendruan kryesisht në zgjidhjet teknologjike, të tilla si përdorimi i software-it filtrues, por vitet e fundit, ka pasur një rritje të teknologjisë së informacionit dhe si rezultat, kompjuterat më tradicionalë desktop nuk janë më pika e vetme e aksesimit të internetit. Rritja e numrit të telefonave mobile, tabletët, asistentët personalë dixhitalë dhe pajisjet e lojrave ofrojnë lidhje kudo dhe fëmijët e të rinjtë mund të kenë qasje në internet ndërkohë që janë në shkollë, në shtëpi, në bibliotekë, në një kafe, një fast-food, një klub rinor apo edhe duke udhëtuar për në shkollë me anë të transportit publik. Shkollat ofrojnë mundësinë për të punuar në internet, në një rrjet të mbyllur. E dukshme është që masat fillestare duhet të përfshijnë vendosjen e sigurisë efektive në rrjet. Fëmijë dhe të rinj mund të kenë pajisje personale që nuk janë të mbrojtura gjatë përdorimit të internetit dhe kjo është arsyeja pse arsimi, diskutimi dhe dialogu janë thelbësore.
- Politikat e sigurisë në internet duhet të hartohen dhe zbatohen për të përfshirë një gamë të gjerë të grupeve të interesit si:
 - drejtuesit e shkollës;
 - senatorët;
 - menaxhmenti i lartë;
 - mësuesit në klasë;
 - staf mbështetës;
 - prindërit ose kujdestarët;
 - personeli i autoritetit lokal;
 - aty ku është e mundur, ofruesit e shërbimeve të Internetit dhe ata që ofrojnë internet dhe shërbime për shkollat;

Meqenëse të gjitha këto grupe kanë njohuri që mund të ndihmojnë në vendosjen e politikave shkollore, është e rëndësishme që të këshillohen të gjithë. Sidoqoftë, thjesht të kesh politika nuk është e mjaftueshme dhe fëmijët e të rinjtë duhet të ndërmarrin praktika aktive që ndihmojnë stafin për të identifikuar dhe për të arritur sjellje të sigurt. Duke përfshirë të gjitha këto grupe, duhet të jenë koshient për rëndësinë e politikave të tilla, si dhe për përgjegjësinë e tyre personale për t'i bërë ato reale.

Krijimi i një ambienti të sigurt për të mësuar TIK ka disa elementë të rëndësishëm, të cilët përfshijnë faktorët në vijim:

- një infrastrukturë e ndërgjegjësimit për të gjithë vendin;
- përgjegjësitë, politikat dhe procedurat;
- një gamë efektive e mjeteve teknologjike;
- një edukim gjithëpërfshirës për sigurinë elektronike;
- program për të gjithë në institucion;
- një proces rishikimi që monitoron vazhdimisht efektivitetin e mjedisit mësimor të TIK;

Të gjitha këto duhet të përfshihen në politikat ekzistuese të sigurisë së fëmijëve brenda shkollës, në vend që të shihet si diçka e menaxhuar vetëm nga një ekip i TIK-ut. Nuk është e saktë të mendosh se ngacmimi përmes internetit ose përmes telefonit celular është diçka ndryshe nga ngacmimi në botën offline. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që teknologjia nuk mund të jetë gjithashtu e rëndësishme si pjesë e zgjidhjes përmes vendosjes së:

- parandalimi dhe mbrojtja nga viruset
- Sistemet e monitorimit për të parë se kush shkarkoi çfarë, kur u ngarkua, dhe cili kompjuter është përdorur;
- filtrimi dhe kontrolli i përmbajtjes për të minimizuar përmbajtjen e papërshtatshme përmes rrjetit shkollor;

Problemet që lindin në lidhje me teknologjitë e reja nuk vlejné për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë dhe kur problemet lindin, ato varen nga mosha e fëmijëve dhe të rinjve që janë duke përdorur këto teknologji. Në fund të vitit 2008, Task Forca Teknike e Sigurisë në Internet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës prodhuan një raport mbi rritjen e sigurisë së fëmijëve dhe teknologjive në internet i cili ofroi një përmbledhje të dobishme të literaturës së hulumtimit origjinal, të botuar, duke adresuar në internet kërkesa seksuale, ngacmimet dhe ekspozime ndaj përmbajtjes problematike.⁶⁰ Brenda këtij raporti u theksua se, “Ekziston një farë shqetësimi që mediat kryesore nuk e zmadhojnë këte frikë, duke e bërë ato jo proporcionale me rreziqet me të cilat përballen të rinjtë”. Mbi dhjetë vjet më vonë dhe është akoma rasti kur prindërit dhe arsimtarët bombardohen me tërheqjen e vëmendjes me anë të titujve që kanë më shumë të ngjarë të inkurajojnë të rriturit të kufizojnë qasjen në shërbimet në internet sesa të edukojnë dhe fuqizojnë fëmijët që t'i përdorin ato në mënyrë të sigurt.

Kjo krijon një rrezik që risqet e njohura të mbeten të fshehura dhe zvogëlon gjasat që shoqëria të jetë e aftë të trajtojë faktorët që çojnë drejt rrezikut, që mund të jenë padashur të dëmshëm. Mbulimi mediatik i këtij fenomeni ndaj fëmijëve dhe të rinjve shpesh duket se pasqyron në mënyrë të polarizuar pozicionet e profesionistëve dhe akademikëve që punojnë në këtë fushë, midis atyre që mendojnë se ekziston rreziku i shtrembërimit të kërcënimit që paraqitet për fëmijët dhe të rinjtë, dhe ata për të cilët duket se kërcënimi është nënvlerësuar.

Sidoqoftë, ekziston shqetësimi se interneti mund të lërë disa fëmijë dhe të rinjtë vulnerabël dhe mësuesit, së bashku me prindërit dhe kujdestarët kanë përgjegjësi në lidhje me këtë. Mënyrat e ndryshme në të cilat fëmijët dhe të rinjtë mund të viktimizohen në internet janë:

- kërkesa ose mesazhe ndaj fëmijëve;
- ekspozimi ndaj materialeve problematike ose të paligjshme;
- ekspozimi ndaj një mediumi që mund të nxisë sjellje të dëmshme nga të rinjtë;
- ngacmimi në internet.

Një mënyrë e dobishme për klasifikimin e rreziqeve në internet për fëmijët u prezantua në Figurën 7.

⁶⁰ ISTTF (2008), *Enhancing Child Safety and Online Technologies: Final Report of the Internet Safety Technical Task Force to the Multi-State Working Group on Social Networking of State Attorneys General of the United States*, https://cyber.harvard.edu/sites/cyber.law.harvard.edu/files/ISTTF_Final_Report.pdf.

Treguesit e arsimit joformal

Krahas shkollës dhe shtëpisë, fëmijët ka të ngjarë të kenë qasje në internet dhe të përdorin shërbime në mjedise joformale p.sh.klube rinore ose grupe kishash. Ndërthurja e jetës në internet dhe jashtë tij për fëmijë dhe të rinj do të thotë se ata që punojnë me fëmijë në mjedise të tilla ka të ngjarë të ketë një ndikim në mjedisin dixhital të fëmijëve dhe sigurinë e tyre në internet, edhe nëse nuk është fokusi kryesor i tyre. Prandaj, të gjithë ata që punojnë në mjedise joformale duhet të kenë disa njohuri të rreziqeve dhe mundësive dhe të jenë në gjendje të mbështesin fëmijët në mënyrë të përshtatshme ose të aksesojnë në ndihmën dhe trajnimin që ata kërkojnë.

Konsideratat kryesore dhe parimet e udhëzimeve për kujdestarët gjithashtu zbatohen në mjedise të tilla megjithatë mund të ketë disa ndryshime kontekstuale ose konsiderata shtesë.

Menaxhimi i pajisjeve, filtrimi dhe komunikimi

Stafi ndihmës, vullnetarët dhe fëmijët mund të kenë më shumë gjasa të kenë akses në internet përmes pajisjeve apo sistemeve informale dhe përmbajtja e filtruar mund të jetë më pak e disponueshme ose më pak e fortë se në shkolla. Prandaj, duke siguruar që praktikuesit dhe fëmijët të kuptojnë se si të sigurojnë dhe menaxhojnë pajisjen e tyre, mund të kërkojë një fokus më të madh në treguesit informal. Edhe nëse sistemet kanë mundësi filtrimi të disponueshme më pak të sofistikuar, edukatorët dhe fëmijët nuk duhet të mbështeten tek ta për mbrojtje.

Treguesit informal duhet të kenë politika më të forta dhe të mbështetura mirë për mbrojtjen e fëmijëve dhe udhëzime - megjithatë në disa mjedise kujdestarët ose vullnetarët mund të mos kenë akses në treguesit e një pajisjeje ose llogarie elektronike të organizatës. Konsiderata shtesë duhet, pra, t'i jepet përdorimit të pajisjeve personale dhe se si të monitorohet / menaxhohet në mënyrë të sigurt në politika dhe në praktikë.

Në mënyrë të ngjashme, pa mbështetjen e arsimit në teknologji dhe të pajisjeve të tij ka të ngjarë që media të ketë një rol më kryesor në shpërndarjen e mesazheve sensibilizuese sesa mjedisi shkollor. Prandaj, konsideratë shtesë mund të jetë të nevojshme politika organizative, praktika dhe trajnime për të identifikuar nëse / si përdoren dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt.

Trajnim dhe mbështetje

Kujdestarët dhe vullnetarët që punojnë në mjedise joformale mund të kenë më pak mundësi të angazhohen me trajnime, të azhurnojnë aftësitë e tyre ose të hyjnë në gamën e mbështetjes që mund të jetë në dispozicion të arsimtarëve në mjediset zyrtare. Kështuqë duhet të merret në konsideratë një mënyrë se si organizatat informale të gjejnë, ofrojnë, financojnë dhe mbështesin këto trajnime.

Tabela 2 identifikon disa nga fushat kryesore të shqyrtimit për kujdestarët.

.

10. Udhëzime për kujdestarët

Është pranuar që mësuesit / kujdestarët individualë nuk do të kenë kontroll mbi disa prej fushave për shqyrtim në Tabelën 2 më poshtë, siç janë filtrimi dhe monitorimi. Pritet që këto veprime do të ndërmerren nga shkolla ose mjedisi arsimor.

Tabela 2: Fushat kryesore për t'u patur në konsideratë nga kujdestarët

	#	Fushat kryesore për t'u pasur konsideratë	Përshkrimi
Siguria dhe pajisjet e sigurisë	1	Sigurohuni që të gjitha pajisjet janë të sigurta dhe mbrojtur me fjalëkalim.	Mësuesit janë aq të prekshëm sa çdokush tjetër nga sulmet kibernetike, viruset dhe hakuesit. Është e rëndësishme që mësuesit të sigurojnë që çdo pajisje që përdor t'i mbrojnë siç duhet (me fjalëkalime të forta) dhe t'i kyçë kur nuk i përdor. (p.sh. nëse një mësues ka nevojë të largohet klasa, çdo pajisje që ata janë duke përdorur duhet të jetë i bllokuar ose të shkëputur nga llogaria).
	2	Instalo Anti-Virus	Sigurohuni që të gjitha pajisjet të kenë një firewall dhe program anti-virus të instaluar dhe ky i fundit të mbahet i azhurnuar.
Politikat	3	Të gjitha shkollat duhet të kenë politika se ku dhe si mundet të përdoret teknologjia brenda në shkollë nga palët e interesuara dhe si menaxhohet mbrojtja e fëmijëve ndaj incidenteve në internet.	Mësuesit duhet të ndjekin politikat dhe rregullat në lidhje me përdorimin e celularit dhe pajisjeve të tjera elektronike. Është e rëndësishme që mësuesit të modelojnë sjelljen e saktë kur përdoren pajisjet. Shkollat duhet të specifikojnë se ku dhe kur mund të përdoren pajisje të lëvizshme.
	4	Imazhe të nxënësve.	Shkollat duhet të kenë një politikë e cila detajon nëse mund të merren fotot e nxënësve. A është në gjendje stafi të bëjë fotografi për qëllime arsimore? Ka leje përkatëse të dhënë nga prindërit/kujdestarët / nxënësit? Idealisht politika duhet të deklarojë që pajisjet personale nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera në mënyrë që të mbrojnë nxënësit dhe personelin.

Filtrimi dhe monitorimi	5	Sigurohuni që shërbimi i internetit nga shkolla është i filtruar dhe monitoruar.	<p>Nxënësit nuk duhet të kenë mundësi të aksesojnë përmbajtje të dëmshme ose të papërshtatshme nga sistemet e shkollës. Asnjë sistem filtrimi nuk mund të jetë 100% efektiv dhe është e rëndësishme për të mbështetur këto zgjidhje teknike me mësimdhënie të mirë si dhe mbikëqyrjen efektive. Filtrimi duhet të parandalojë qasjen në përmbajtje të paligjshme nëse përmbajtja konsiderohet e papërshtatshme ose e dëmshme. Si shembull, në vijim kategoritë e përmbajtjes së dëmshme konsiderohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diskriminimi • Gjuha e urrejtjes • Abuzimi me drogën ose substancat • Ekstremizmi • Pornografia • Pirateria dhe vjedhja e të drejtës së autorit • Përmbajtja e vetëlëndimit ose vetëvrasjes • Dhuna ekstreme
Reputacioni online/ Gjurme dixhitale	6	Vlerësoni rëndësinë e gjurmëve dixhitale dhe rëndësinë e reputacionit online	<p>Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se çfarë ata thonë dhe bëjnë në internet pasi kjo mund të ndikojë në reputacionin e tyre dhe gjithashtu reputacionin e shkollës. Mësuesit gjithmonë duhet të veprojnë në mënyrë profesionale në internet. Fëmijët gjithashtu duhet të mësohen për rëndësinë e reputacionit në internet dhe si të menaxhohet kjo në mënyrë efektive.</p>

Si të komunikojmë profesionalisht në mënyrë të sigurt?	7	Njohja e rëndësisë së komunikimit profesional online me nxënësit, prindërit dhe palët e tjera të interesit.	<p>Gjithmonë duhet të ketë një kufi të qartë midis jetës personale të një mësuesi dhe profesionale - kjo përfshin aktivitetet në internet. Një adresë e-mail në shkollë duhet të përdoret për komunikim ndërmjet personelit dhe nxënësve/prindërve. Shkollat mund të sigurojnë politikat e komunikimit ose kodet e sjelljes të cilat ndalojnë rreptësisht komunikimin pa një qëllim arsimor ose në platforma joshkollore.</p> <p>Idealisht pajisjet personale nuk duhet të përdoren për të komunikuar me nxënës ose prindërit / kujdestarët. Komunikimi personal dixhital duhet të shmanget.</p> <p>Nëse një video-konferencë ose të mësuarit në distancë po zhvillohet, shkollat duhet të jenë të qarta për vendet e të dy stafit dhe</p>
--	---	---	--

			nxënësit. (p.sh. duke menduar se ku mësimi / komunikimi dixhital është duke u zhvilluar psh. jo në një dhomë gjumi)
Sjellja e nxënësit, cenueshmëria në internet dhe ndikimi në ruajtjen e mirëqenien	8	Kuptimi i rreziqeve dhe përfitimeve që nxënësit mund të jenë të ekspozuar, kur ata qëndrojnë në internet	Mësuesit duhet të kenë një mirëkuptim me fëmijët dhe të rinjtë në lidhje me ato çka bëjnë kur hyjnë në internet dhe rreziqet dhe përfitimet me të cilat mund të përballen.

11. Përfundim

Teknologjitë e informacionit dhe komunikacionit (TIK) kanë transformuar stilet e jetës moderne. Ata kanë siguruar komunikime në kohë reale, qasje pa kufij dhe informacion pothuajse të pakufizuar dhe një gamë të gjerë shërbimesh inovatore. Në të njëjtën kohë, ato gjithashtu kanë krijuar mundësi të reja për shfrytëzim dhe abuzim. Pa mbrojtjen e duhur, fëmijët dhe të rinjtë- ndër përdoruesit më të mëdhenj të internetit - janë në rrezik të favoreve të padëshiruara seksuale, ngacmimeve dhe ekspozimit të padëshiruar ndaj materialeve me përmbajtje të dhunshme, seksuale dhe shqetësuese.

Pa mekanizmat e duhur për të krijuar një mjedis të sigurt kibernetik, fëmijët dhe të rinjtë do të mbeten të prekshëm. Megjithëse është rritur ndërgjegjësimi për rreziqet që lidhen me përdorimin e pasigurt të TIK-ut, mbetet akoma një punë e konsiderueshme për t'u bërë. Prandaj, është thelbësore që prindërit dhe kujdestarët të diskutojnë dhe të vendosin me fëmijët dhe të rinjtë se çfarë është e përshtatshme dhe e sigurt për përdorimin e tyre, si dhe si të sillen me përgjegjësi duke përdorur TIK.

Duke punuar së bashku, prindërit, kujdestarët, fëmijët dhe të rinjtë mund të korrin përfitimet e TIK, ndërsa në të njëjtën kohë minimizojnë rreziqet e mundshme për fëmijët dhe të rinjtë.

Terminologjia

Përkufizimet më poshtë janë marrë kryesisht mbi terminologjitë ekzistuese siç janë përpunuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, 1989, si dhe nga grupi punues i agjensive ndërkombëtare për shfrytëzimin seksual të fëmijëve në Udhëzimet e Terminologjisë për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi seksual, 2016⁶¹ (Udhëzimet e Luksemburgut), nga Konventa e Këshillit të Evropës: Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, 2012⁶² si dhe nga Raporti Global Kids Online, 2019⁶⁵.

Adoleshent

Adoleshentët janë persona të moshës 10-19 vjeç. Është e rëndësishme të theksohet se adoleshent nuk është një term i detyrueshëm sipas ligjit ndërkombëtar dhe ata nën moshën 18 vjeç konsiderohen të jenë fëmijë, ndërsa 19 vjeç konsiderohen të rritur, përveçse nëse matura arrihet më herët sipas ligjit kombëtar.⁶³

Inteligjenca Artificiale (AI)

Në kuptim të gjerë, termi i referohet në mënyrë të turbullt sistemeve që janë trillime shkencore (të ashtëquajturat AI "të forta" me një formë të vetëdijshme) dhe sistemeve që janë tashmë operacionale dhe të afta për të kryer detyra shumë komplekse (njohja e fytyrës ose zërit, drejtimi i automjetit - këto sisteme përshkruhen si AI "të moderuar").⁶⁴

Sistemet e AI

Një sistem AI është një sistem i bazuar në makinë që mund, për një grup të caktuar objektivash të përcaktuara nga njeriu, të bëjë parashikime, rekomandime ose vendime që ndikojnë në mjedise reale ose virtuale dhe janë krijuar për të funksionuar me nivele të ndryshme të autonomisë.⁶⁵

Alexa

Amazon Alexa, e njohur thjesht si **Alexa**, është një asistent virtual i Inteligjencës Artificiale i zhvilluar nga Amazon. Ai është i aftë për ndërveprim me zë, riprodhim muzikor, bërjen e listave të detyrave, vendosjen e alarmeve, transmetimin e këngëve, leximin e librave audio dhe transmetimin e motit, trafikut, sporteve dhe informacioneve të tjera në kohë reale, të

⁶¹ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*,

<http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf>

⁶² Council of Europe (2012), *Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse: Council of Europe Convention*, https://www.coe.int/t/dg3/children/1in5/Source/Lanzarote%20Convention_EN.pdf .⁶⁵

Globalkidsonline.net (2019), *Done Right, Internet Use Can Increase Learning and Skills*, <http://globalkidsonline.net/synthesis-report-2019/> .

⁶³ UNICEF and ITU (2015), *Guidelines for Industry on Child Online Protection*, https://www.itu.int/en/cop/Documents/bD_Broch_INDUSTRY_0909.pdf .

⁶⁴ Council of Europe (2020), *What's AI?*, <https://www.coe.int/en/web/artificial-intelligence/what-is-ai> .

⁶⁵ OECD (2019), *Recommendation of the Council on Artificial Intelligence*, <https://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:hTtMv9k1ak8J:https://legalinstruments.oecd.org/api/print%3Fids%3D648%26lang%3Den+&cd=3&hl=en&ct=clnk&gl=ch&client=safari> .

tilla si lajmet. Alexa gjithashtu mund të kontrollojë disa pajisje inteligjente duke përdorur veten si një sistem automatizimi në shtëpi. Përdoruesit janë në gjendje të zgjerojnë aftësitë e Alexa duke instaluar "aftësi" (funksionalitet shtesë i zhvilluar nga shitës të palëve të treta, në settings të tjera më shpesh të quajtura aplikacione të tilla si programet e motit dhe veçoritë e audios).⁶⁶

Në interes të fëmijës

Përshkruan të gjithë elementët e nevojshëm për të marrë një vendim në një situatë specifike për një fëmijë specifik ose grup fëmijësh.⁶⁷

Fëmijë

Në përputhje me nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, një fëmijë është kushdo nën 18 vjeç, përveç nëse matura arrihet më herët sipas ligjit kombëtar.⁶⁸

Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i fëmijëve (CSEA)

Përshkruan të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual (CRC, 1989, art. 34), p.sh. "(a) shtytja ose detyrimi i një fëmije për t'u përfshirë në aktivitet seksual të paligjshëm; (b) Përdorimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve në prostitucion ose praktika të tjera të paligjshme; (c) Përdorimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve në shfaqje dhe materiale pornografike si një "kontakt seksual që zakonisht përfshin forcë ndaj një personi pa pëlqim."⁶⁹ Shfrytëzimi seksual dhe abuzimi i fëmijëve bëhen gjithnjë e më shumë përmes internetit, ose me ndonjë lidhje në mjedisin online.⁷⁰

Materiali i shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve (CSAM)

Evolucioni i shpejtë i TIK ka krijuar forma të reja të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve në internet, të cilat mund të ndodhin virtualisht dhe nuk janë të detyruar të përfshijnë takime fizike ballë për ballë me fëmijën.⁷¹ Megjithëse shumë akte ligjore ende

⁶⁶ Amazon (2019), *Alexa Skills Kit Official Site: Build Skills for Voice*, <https://developer.amazon.com/en-US/alexa/alexa-skills-kit>.

⁶⁷ OHCHR (1990), *Convention on the Rights of the Child*, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>.

⁶⁸ UNICEF and ITU (2015), *Guidelines for Industry on Child Online Protection*, https://www.itu.int/en/cop/Documents/bD_Broch_INDUSTRY_0909.pdf

⁶⁹ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*, <http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf>.

⁷⁰ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*, <http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf>.

⁷¹ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*, <http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf> .;" UNICEF and Global Kids Online (2019), *Global*

etiketojnë imazhe dhe video të abuzimit seksual të fëmijëve si 'pornografia e fëmijëve' ose 'imazhet e pahijshme të fëmijëve', këto udhëzime do t'u referohen subjekteve kolektivisht si material i abuzimit seksual të fëmijëve (tani e tutje, CSAM). Kjo është në përputhje me Udhëzimet e Komisionit të Broadband dhe WePROTECT Global Model National Response.

Alliance.⁷² Ky term përshkruan më saktë përmbajtjen. Pornografia i referohet një industrie të ligjshme, të komercializuar dhe siç përcaktojnë udhëzimet e Luksemburgut përdorimin e termit:

“Mund (pa dashje ose jo) të kontribuojë në zvogëlimin e gravitetit të banalizimit, apo edhe legjitimitin e asaj që në të vërtetë është abuzim seksual dhe/ose shfrytëzim seksual i fëmijëve [...] termi ‘pornografia e fëmijëve’ rrezikon të nënkuptojë se veprimet kryhen me pëlqimin e fëmijës dhe përfaqësojnë material të ligjshëm seksual”.⁷³

Termi CSAM i referohet materialit që përfaqëson veprime që janë seksualisht abuzive dhe/ose shfrytëzuese për një fëmijë. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, material që regjistron abuzimin seksual të fëmijëve nga të rriturit; imazhe të fëmijëve të përfshirë në sjellje të qarta seksuale; organet seksuale të fëmijëve kur imazhet prodhohen ose përdoren për qëllime kryesisht seksuale.

Fëmijët dhe të rinjtë

Përshkruan të gjithë personat nën moshën 18 vjeç, ku fëmijët, të referuar edhe si fëmijë të vegjël, përfshijnë të gjithë personat nën moshën 15 vjeç dhe të rinjtë përbëhen nga grupmosha 15 deri 18 vjeç.

Lojrat e lidhura me internet

Lodrat e lidhura me internetin duke përdorur teknologji të tilla si Wi-Fi dhe Bluetooth dhe zakonisht funksionojnë së bashku me aplikacionet shoqëruese për të mundësuar lojë interaktive për fëmijët. Sipas Juniper Research, në vitin 2015 tregu për lodrat e lidhura me internet arriti në 2.8 miliardë dollarë dhe parashikohet të rritet në 11 miliardë dollarë deri në vitin 2020. Këto lodra mbledhin dhe ruajnë informacione personale nga fëmijët duke përfshirë emrat, vendndodhjen gjeografike, adresat, fotografitë, audion dhe video regjistrimet.⁷⁴

Kids Online Comparative Report, https://www.unicef.org/publications/pdf/GKO_LAYOUT_MAIN_REPORT.pdf.

⁷² WePROTECT Global Alliance (2016), *Preventing and Tackling Child Sexual Exploitation and Abuse (CSEA): A Model National Response.*, <https://static1.squarespace.com/static/5630f48de4b00a75476ecf0a/t/582ba50bc534a51764e8a4ec/1479255310190/WePROTECT+Global+Alliance+Model+National+Response+Guidance.pdf>; Broadband Commission (2019), *Child Online Safety: Minimizing the Risk of Violence, Abuse and Exploitation Online*, https://broadbandcommission.org/Documents/working-groups/ChildOnlineSafety_Report.pdf.

⁷³ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*, <http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf>

⁷⁴ Jeremy Greenberg (2017), *Dangerous Games: Connected Toys, COPPA, and Bad Security*, <https://georgetownlawtechreview.org/dangerous-games-connected-toys-coppa-and-bad-security/GLTR-12-2017/>.

Bullizmi Kibernetik

Bullizmi kibernetik përshkruan një veprim të qëllimshëm agresiv të kryer në mënyrë të përsëritur nga një grup ose një individ duke përdorur teknologji dixhitale dhe duke synuar një viktimë që nuk mund të mbrohet.⁷⁵ Zakonisht përfshin "përdorimin e teknologjisë dixhitale dhe internetit për të postuar informacione të dëmshme për dikë, duke shpërndarë qëllimisht informacione private, fotografi ose video në një mënyrë të dëmshme, duke dërguar mesazhe kërcënuese ose fyese (përmes postës elektronike, mesazheve, bisedave, teksteve), përhapjes së thashethemeve dhe informacioneve të rreme për viktimën ose përjashtimin e tyre me qëllim nga komunikimet online"⁷⁶. Mund të përfshijë komunikime të drejtpërdrejta (të tilla si biseda ose mesazhe me tekst), gjysmë publike (të tilla si postimi i një mesazhi ngacmues në një listë e-mail) ose komunikime publike (të tilla si krijimi i një faqe në internet kushtuar talljes me viktimën).

Urrejtja Kibernetike, diskriminimi dhe ekstremizëm i dhunshëm

"Urrejtja kibernetike, diskriminimi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë një formë e veçantë e dhunës kibernetike pasi synon një identitet kolektiv, sesa individë [...] shpesh që kanë të bëjnë me racën, orientimin seksual, fenë, kombësinë ose statusin e imigracionit, seksin/gjininë dhe politikën"⁷⁷.

Shtetësi dixhitale

Shtetësia dixhitale i referohet aftësisë për t'u angazhuar pozitivisht, në mënyrë kritike dhe me kompetencë në mjedisin dixhital, duke u mbështetur në aftësitë e komunikimit dhe krijimit efektiv, për të praktikuar forma të pjesëmarrjes sociale që respektojnë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut përmes përdorimit të përgjegjshëm të teknologjisë.⁷⁸

Njohuri dixhitale

Njohuri dixhitale do të thotë të kesh aftësitë që i duhen dikujt për të jetuar, mësuar dhe punuar në një shoqëri ku komunikimi dhe qasja në informacion është gjithnjë e më shumë përmes teknologjive dixhitale si platformat e Internetit, mediat sociale dhe pajisjet mobile.⁷⁹ Ai përfshin komunikim të qartë, aftësi teknike dhe mendim kritik. **Elasticiteti dixhital**

⁷⁵ Anna Costanza Baldry, Anna Sorrentino, and David P. Farrington (2019), *Cyberbullying and Cybervictimization versus Parental Supervision, Monitoring and Control of Adolescents' Online Activities*, <https://doi.org/10.1016/j.childyouth.2018.11.0058>.

⁷⁶ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*, <http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf> .;"UNICEF and Global Kids Online (2019), *Global Kids Online Comparative Report*, https://www.unicef.org/publications/pdf/GKO_LAYOUT_MAIN_REPORT.pdf

⁷⁷ UNICEF and Global Kids Online (2019), *Global Kids Online Comparative Report*, https://www.unicef.org/publications/pdf/GKO_LAYOUT_MAIN_REPORT.pdf

⁷⁸ Council of Europe (date?), *Digital Citizenship and Digital Citizenship Education*, <https://www.coe.int/en/web/digital-citizenship-education/home>.

⁷⁹ Western Sydney University-Claire Urbach (date?), *What Is Digital Literacy?*, https://www.westernsydney.edu.au/studysmart/home/digital_literacy/what_is_digital_literacy.

Ky term përshkruan aftësinë e një fëmije për të përballuar emocionalisht dëmet në internet. Elasticiteti dixhital përfshin aftësinë emocionale për të kuptuar kur fëmija rrezikohet në internet, të dijë çfarë të bëjë për të kërkuar ndihmë, për të mësuar nga përvoja dhe për t'u rikuperuar kur gjërat shkojnë keq.⁸⁰

Kujdestarët

Një kujdestar është një person i cili punon në mënyrë sistematike për të përmirësuar kuptimin e një personi tjetër për një temë të caktuar. Roli i kujdestarëve përfshin si ata që japin mësim në klasa ashtu edhe ata më informalë të cilët, për shembull, përdorin platforma dhe shërbime të rrjeteve sociale për të siguruar informacion online mbi sigurinë ose për të drejtuar kurse të bazuara në komunitet/shkollë për të mundësuar që fëmijët dhe të rinjtë të qëndrojnë të sigurt në internet.

Puna e kujdestarëve do të ndryshojë në varësi të kontekstit në të cilin ata punojnë dhe grupmoshës së fëmijëve dhe të rinjve (ose të rriturve) që ata kërkojnë të arsimojnë.

Senatorët

Përshkruan të gjithë personat që kanë një pozitë në menaxhimin e shkollës/strukturën e qeverisjes së saj.

Abuzimi seksual me fëmijët online

Pedofili me biseda online siç përcaktohet në Udhëzimet e Luksemburgut, i referohet procesit të krijimit/ndërtimit të një marrëdhënieje me një fëmijë, ose personalisht ose përmes përdorimit të Internetit për të lehtësuar kontaktin seksual në internet me atë person që e bind fëmijën të ketë një marrëdhënie seksuale.⁸¹ Është një proces që synon të joshë fëmijët në sjellje seksuale ose biseda me ose pa dijeninë e tyre, një proces që përfshin komunikimin dhe socializimin ndërmjet shkelësit dhe fëmijës në mënyrë që ta bëjë atë më të prekshëm ndaj abuzimit seksual.

Teknologjitë e informacionit dhe komunikacionit (TIK)

Teknologjitë e informacionit dhe komunikacionit përshkruajnë të gjitha teknologjitë e informacionit që ndikojnë në komunikimin online. Kjo përfshin të gjitha shërbimet dhe pajisjet që lidhin internetin, siç janë ndër të tjera kompjuteri, laptopët, tabletët, telefonat, pajisjet e lojërave, televizorët.⁸²

Lojërat online

Lojërat online 'përcaktohen si të luajturit e çdo loje dixhitale komerciale me një ose më shumë lojtarë përmes çdo pajisjeje të lidhur me Internetin, duke përfshirë pajisjet e dedikuara, kompjuterët desktop, laptopët, tabletët dhe celularët.

⁸⁰ Dr. Andrew K. Przybylski, et al. (2014), *A Shared Responsibility. Building Children's' Online Resilience Report*, <https://parentzone.org.uk/sites/default/files/Building%20Online%20Resilience%20Report.pdf>.

⁸¹ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*,

<http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf>

⁸² UNICEF and ITU (2015), *Guidelines for Industry on Child Online Protection*, https://www.itu.int/en/cop/Documents/bD_Broch_INDUSTRY_0909.pdf.

Ekosistemi i lojërave në internet përcaktohet për të përfshirë vëzhgimin e të tjerëve duke luajtur lojëra video përmes e-sporteve, transmetimeve ose platformave të ndarjes së videove, të cilat zakonisht ofrojnë mundësi për shikuesit për të komentuar ose për të bashkëvepruar me lojtarët dhe anëtarët e tjerë.⁸³

Mjetet e kontrollit prindëror

Program kompjuterik që lejon përdoruesit, zakonisht një prind, të kontrollojë disa ose të gjitha funksionet e një kompjuteri ose pajisje tjetër që mund të lidhet me internetin. Në mënyrë tipike, programe të tilla mund të kufizojnë hyrjen në faqe të veçanta të internetit ose shërbimeve online. Disa gjithashtu ofrojnë hapësirë për menaxhimin e kohës, d.m.th., pajisja mund të vendoset të ketë qasje në internet vetëm midis orëve të caktuara. Versione më të përparuara mund të regjistrojnë të gjitha tekstet e dërguara ose të marra nga një pajisje. Programet mbrohen me fjalëkalim.⁸⁴

Prindërit, kujdestarët, roje

Disa faqe në internet u referohen prindërve në një mënyrë të përgjithshme (si në "faqja e prindërve" dhe i referohen "kontrolleve prindërore") Prandaj është e dobishme të përcaktohen njerëzit që në mënyrë ideale fuqizojnë fëmijët për të maksimizuar mundësitë e disponueshme në internet, të sigurohen që fëmijët dhe të rinjtë të përdorin faqet e internetit në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi dhe të japin pëlqimin e tyre për të pasur akses në faqet specifike të Internetit. Në këtë dokument, termi "prind" i referohet kujt do (duke përjashtuar edukatorë) i cili ka një përgjegjësi ligjore për një fëmijë. Përgjegjësia prindërore ndryshon nga vendi në vend, ashtu si të drejtat ligjore të prindërve.

Informacion personal

Termi përshkruan informacione të identifikueshme për një individ, të cilat mblidhen online. Kjo përfshin emrin e plotë, detajet e kontaktit si shtëpia dhe adresat e postës elektronike, numrat e telefonit, gjurmët e gishtave ose materiali për njohjen e fytyrës, numrat e sigurimit ose ndonjë faktor tjetër, që lejon kontaktin fizik ose online ose lokalizimin e një personi. Në këtë kontekst, i referohet çdo informacioni në lidhje me një fëmijë që mblidhet online nga ofruesit e shërbimeve në internet, përfshirë lodrat e lidhura dhe çdo teknologji tjetër të lidhur.

Privatësia

Privatësia shpesh matet në aspektin e ndarjes së informacionit personal në internet, të paturit të një profili publik në media sociale, ndarjes së informacionit me njerëzit që janë njohur online, përdorimit të cilësimeve të privatësisë, ndarjes së fjalëkalimeve me miqtë, shqetësimet rreth privatësinë.⁸⁵

⁸³ UNICEF (2019), *Child Rights and Online Gaming: Opportunities & Challenges for Children and the Industry*, https://www.unicef-irc.org/files/upload/documents/UNICEF_CRBDigitalWorldSeriesOnline_Gaming.pdf.

⁸⁴ UNICEF and ITU (2015), *Guidelines for Industry on Child Online Protection*, https://www.itu.int/en/cop/Documents/bD_Broch_INDUSTRY_0909.pdf.

⁸⁵ US Federal Trade Commission (1998), *Children's Online Privacy Protection Act*, <https://www.ecfr.gov/cgi-bin/text->

Sexting

Seksting zakonisht përcaktohet si dërgimi, marrja ose shkëmbimi i përmbajtjes seksuale të vetë-prodhuar, duke përfshirë imazhe, mesazhe ose video përmes telefonave celularë dhe/ose internetit.⁸⁶ Krijimi, shpërndarja dhe posedimi i imazheve seksuale të fëmijëve është i paligjshëm në shumicën e vendeve. Nëse zbulohen imazhe seksuale të fëmijëve, të rriturit nuk duhet t'i shohin ato. Ndarja e imazheve seksuale nga një i rritur me një fëmijë është gjithmonë një veprim kriminal dhe se midis fëmijëve mund të ndodhë dëmtim dhe mund të nevojiten raportime dhe veprime për të hequr imazhet e shpërndara.

Zhvatja seksuale e fëmijëve

Zhvatja ose zhvatja seksuale e fëmijëve përshkruan “shantazhin ndaj një personi me ndihmën e imazheve të gjeneruara nga ai person në mënyrë që të marrë favore seksuale, para ose përfitime të tjera prej tij/saj nën kërcënimin e ndarjes së materialit pa pëlqimin e personit (p.sh. postimi i imazheve në mediat sociale)”.⁸⁷

The Internet of Things

Internet of Things përfaqëson hapin tjetër drejt dixhitalizimit të shoqërisë dhe ekonomisë, ku objektet dhe njerëzit janë të ndërlidhur përmes rrjeteve të komunikimit dhe raportojnë për statusin e tyre dhe/ ose mjedisin përreth.⁸⁸

URL

Shkurtesa qëndron për ‘locative uniform locator’, adresa e një faqe në internet.⁸⁹ **Realiteti**

Virtual

Realiteti virtual është përdorimi i teknologjisë kompjuterike për të krijuar efektin e një bote tre-dimensionale interaktive në të cilën objektet kanë një ndjenjë të pranisë hapësinore..⁹⁰

WI-FI

[idx?SID=4939e77c77a1a1a08c1cbf905fc4b409&node=16%3A1.0.1.3.36&rgn=div5](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)bin/text-idx?SID=4939e77c77a1a1a08c1cbf905fc4b409&node=16%3A1.0.1.3.36&rgn=div5.

⁸⁶ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*,

[http://luxembourgguidelines.org/wp-](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)

[content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)

[EN.pdf](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf

⁸⁷ Terminology and Semantics (2016), *Luxembourg Terminology Guidelines for the Protection of Children from Sexual Exploitation and Sexual Abuse*,

[http://luxembourgguidelines.org/wp-](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)

[content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)

[EN.pdf](http://luxembourgguidelines.org/wp-content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf)content/uploads/2017/06/Terminology-guidelines-396922-EN.pdf

⁸⁸ Ntantko (2013), *The Internet of Things, Digital Single Market*, [https://ec.europa.eu/digital-](https://ec.europa.eu/digital-single)

[single](https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/internet-of-things)market/en/internet-of-things.

⁸⁹ UNICEF and ITU (2015), *Guidelines for Industry on Child Online Protection*, https://www.itu.int/en/cop/Documents/bD_Broch_INDUSTRY_0909.pdf.

⁹⁰ NASA (date?), *Virtual Reality*, online under: <https://www.nasa.gov/Software/VWT/vr.html>.

(Wireless Fidelity) është grupi i standardeve teknike që mundësojnë transmetimin e të dhënave përmes rrjeteve pa tela.⁹¹

⁹¹ US Federal Trade Commission (1998), *Children's Online Privacy Protection Act*, <https://www.ecfr.gov/cgi-bin/text-idx?SID=4939e77c77a1a1a08c1cbf905fc4b409&node=16%3A1.0.1.3.36&rgn=div5>bin/text-idx?SID=4939e77c77a1a1a08c1cbf905fc4b409&node=16%3A1.0.1.3.36&rgn=div5.

With the support of:

